



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË NË 2015

Raporti për performancën e kompanive të licensuara të furnizimit me ujë, shërbimeve të ujërave të zeza, furnizimit me shumicë të ujit të patrajtuar

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efçente të ujësjellësit dhe ujërave të zeza për të gjithë konsumatorët në tërë Kosovën.”

Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikën e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit dhe të ujërave të zeza të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.”

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË NË 2015

PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE	5
FJALA E DREJTORIT TË ZYRËS ZVICERANE PËR BASHKËPUNIM (SCO)	7
ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ARRU	9
1 HYRJE	10
2 ZHVILLIMET NË SEKTOR.....	11
Pjesa A	
3. PERFORMANCA INDIVIDUALE E KRU.....	14
3.1 Furnizimi me ujë.....	14
3.2 Shërbimet për ujëra të zeza	29
3.3 Performanca financiare e KRU.....	35
3.4 Performanca e përgjithshme e KRU.....	37
Pjesa B	
4. PERFORMANCA E SEKTORIT	45
4.1 Uji i prodhuar, shitjet dhe UPF.....	45
4.2 Mbulueshmëria me shërbime të ujës-jellësit dhe kanalizimit.....	46
4.3 Të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe paraja e gatshme e arkëtuar.....	46
4.4 Investimet kapitale për shërbime të furnizimit me ujë dhe ujëra të zeza	48
Pjesa C	
5. PERFORMANCA E NHE 'Ibër Lepenci'	50
Pjesa D	
6. AKTIVITETET E KKK.....	52
7. SFIDAT PËR TË ARDHMËN	53
SHTOJCA 1 Të dhënat e detajuara të performancës.....	55
SHTOJCA 2 Definicionet dhe arsyeshmëria	70
SHTOJCA 3 Pasqyrat përmbledhëse e të ardhurave.....	76
SHTOJCA 4 Pasqyrat tarifore(2015-2017).....	79
SHTOJCA 5 Përmbledhje treguesish të performancës-2015.....	80
SHTOJCA 6 Të dhënat statistikore-2015	81
SHTOJCA 7 Detajet kontaktuese	82
SHTOJCA 8 Zonat e shërbimit të KRU	83

Akronimet dhe shkurtesat

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BPRR	Biznes Plane Rregullatore
BB	Banka Botrore
BRRR	Baza Rregullatore e Aseteve
BD	Bordet e Drejtorëve
GKN	Grupi Kordinues Ndërinstitucional për Cilësinë e Ujit
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
KUP	Kualiteti i ujit të Pijshëm
KNMU	Këshillit Ndërmintor për Ujëra
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
KKK	Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve
LUX DEV	Agjencioni për Bashkëpunim dhe Zhvillim i Luksemburgut
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MF	Ministria e Financave
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
PMV	Plani i Monitorimit Vjetor
QU	Qendra e Ujit
SCO	Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë
SHUKOS	Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimeve të Kosovës
UPF	Uji i Pa-Faturuar
UA	Udhëzimi Administrativ
UKRR	Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator
USAID	Agjencioni për Zhvillim Ndërkombëtar i SHBA

FJALA HYRËSE



Kam kënaqësinë që të paraqes raportin e 10-të me radhë të vlerësimit të performancës së ofruesve publik të shërbimeve të ujit në Kosovë.

Mandati ynë kryesor si rregullator ekonomik, duke pasur parasysh monopolin që ofruesit e shërbimeve e kanë në ofrimin e shërbimeve të ujit, është që të sigurojmë se konsumatorët pranojnë nivel të shërbimeve sipas standardeve të përcaktuara dhe atë me kosto sa më të ulët, të përballueshme nga ata.

Sikurse gjatë viteve të kaluara edhe gjatë vitit 2015, në bashkëpunim të përhershëm me ofruesit e shërbimeve dhe akterët tjerë të sektorit, jemi angazhuar në përmirësimin e performancës operative, financiare dhe të shërbimit me konsumatorë të ofruesve të shërbimeve.

Me hyrjen në fuqi të versionit të rishqyrtuar të Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (Ligji nr. 05/I -042), Autoritetit Rregullator i janë shtuar detyrat dhe përgjegjësitë me qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe detyrave për të cilat ky institucion është themeluar.

Nga muaji Prill 2016, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, unë jam ri-zgjedhur Drejtor i këtij institucioni për periudhën e ardhshme 5 vjeçare. Gjatë këtij mandati unë do të vazhdojë angazhimin tim në kryerjen e obligimeve rregullatore dhe do të angazhohem maksimalisht në përmirësimin e shërbimeve të ujit përmes:

- Forcimit të mëtejshëm të kornizës ligjore – përpilimit dhe rishikimit të politikave, rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe dokumenteve tjera relevante;
- Bashkëpunimit me ofruesit e shërbimeve në jetësimin e legjislacionit përkatës - duke mbështetur ofruesit e shërbimeve përmes vizitave, takimeve të punës, si dhe trajnimeve;
- Ruajtjes së qëndrueshmërisë financiare dhe operative të ofruesve të shërbimeve – duke siguruar proces efektiv tarifor që nënkupton “tarifa të përballueshme për qytetarët dhe sigurim i qëndrueshëm financiar për ofruesit e shërbimeve”.
- Monitorimit të vazhdueshëm të ofruesve të shërbimeve dhe sigurimit të vlerësimeve dhe rekomandimeve, për përmirësimin e performancës së ofruesve të shërbimeve.

Edhe pse nga viti në vit ka përmirësime të performancës së ofruesve të shërbimeve në shumicën e treguesve të performancës, si në aspektin individual të çdo ofruesi ashtu edhe në aspektin e përgjithshëm, akoma ballafaqohemi me probleme, përmirësimi i të cilave kërkon angazhim të të gjitha palëve, duke filluar nga ofruesit e shërbimeve, rregullatori, konsumatorët etj.

Me këtë rast do të doja vetëm të i përmbledh disa nga përmirësimet dhe problemet kryesore të performancës së ofruesve të shërbimeve gjatë vitit 2015, të cilat më gjerësisht janë dhënë në kapitujt vijues të këtij Raporti:

- Investimet e konsiderueshme në ngritjen e kapaciteteve prodhuese të ujit për rajonin e Mitrovicës, ku me rastin e funksionalizimit të fabrikës së ujit në Shipol në vitin 2014, është përmirësuar dukshëm vazhdimësia e furnizimit me ujë gjatë vitit 2015;
- Investimet në sistemet rurale (nga komunat, donatorët) kanë ndikuar në zgjerimin e mbulueshmërisë me shërbime të ujit të popullatës së Kosovës;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për shërbime me disa nga komunat ka ndikuar që sistemet lokale të këtyre komunave të integrohen në sistemet regjionale dhe njëherit të rregullohen përmes Autoritetit Rregullator;
- Aplikimi i masave ligjore (përmes përmbartësve dhe faljes/ri-programimit të borxheve) nga ofruesit e shërbimeve ka ndikuar në rritjen e normës së arkëtimit.;

Përkundër përmirësimeve të lartpërmendura, treguesit kryesor si: norma e ujit të pa faturuar dhe norma e arkëtimit, kanë mbetur akoma në vlerat e pa-pranueshme nga Autoriteti Rregullator. Ngecja në përmirësimin e këtyre treguesve ndikon drejtpërdrejt në nivelin e shërbimeve, përmirësimi i të cilave varet shumë nga mjetet monetare të arkëtuara. Nga ana tjetër, numri i lartë i stafit detyron menaxhmentin e ofruesve të shërbimeve që një pjesë të madhe të të ardhurave të arkëtuara të i shfrytëzojnë për shlyerjen e obligimeve për pagat, përderisa ato të ardhura gjatë përcaktimit tarifor të aprovuar nga Autoriteti Rregullator, janë paraparë të shfrytëzohen për përmirësimin e nivelit të shërbimeve.

Si metodat e përdorura për përmirësimet e arritura, ashtu edhe mësimet e nxjerrura nga problemet e ballafaquara gjatë vitit 2015, do të jenë një udhërrëfyes për akterët kryesor të sektorit në përmirësimin e gjendjes në vitet e ardhshme.

Duke folur për përmirësimin e gjendjes në përgjithësi në sektor, dëshiroj të theksoj rëndësinë e përkrahjes së donatorëve ndërkombëtarë. Gjatë vitit 2015 Autoriteti Rregullator ka vazhduar të përkrahet nga Projekti Mbështetës, i cili është pjesë integrale e Programit Mbështetës për Ujësjellës dhe Kanalizim në Zonat Rurale në Kosovë - Faza e V, financuar nga Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Ndër të tjerash, Projekti ka ofruar përkrahje në rishqyrtimin e 'Rregullores për standardet e shërbimeve'; 'Rregullores për kartën e konsumatorit'; si dhe 'Rregullores për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve', të cilat do të fuqizohen në vitin 2016. Nga ana tjetër Projekti i ka përkrahur të shtatë ofruesit e shërbimeve në hartimin e 'Kartës së konsumatorit' dhe 'Kontratës për shërbime', të cilat janë në përputhshmëri me rregulloret e lartpërmendura. Këto dokumente të rëndësishme priten të jetësohen nga viti 2016.

Me këtë rast falënderoj të gjithë donatorët (SCO, BE, KFW, LUX DEV, USAID, BB, etj) të cilët që nga pas lufta kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë në sektorin e ujit në Kosovë.

Për më tepër Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO), ka kontribuar që edhe përmes këtij raporti të ofrojë opinionin e saj për gjendjen e sektorit, si dhe një përmbledhje të rëndësishme në lidhje me gjendjen e kualitetit të ujit si kontribut i drejtpërdrejt për/nga IKSHPK.

Ne shpresojmë se informacionet të cilat gjinden në këtë raport, do të ju shërbejnë palëve të ndryshme të interesit si bazë për planifikim të mëtejshëm të investimeve dhe ndërmarrjen e masave në fushat e identifikuara me ngecje.

Së fundi dëshiroj të falënderoj stafin tim për punën dhe përkushtimin e treguar gjatë hartimit të këtij raporti, si dhe zyrtarët e ofruesve të shërbimeve të cilët janë angazhuar për të raportuar sipas kërkesave rregullatore.

Me respekt,



Raif Preteni
Drejtor i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit

FJALA E DREJTORIT TË ZYRËS ZVICERANE PËR BASHKËPUNIM (SCO)

Të nderuar akterë të Ujit,

Në emër të Qeverisë Zvicerane dhe në emër të Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim (SCO) në kapacitetet e sajë si koordinator i komunitetit donator në sektorin e ujit në Kosovë, kemi nderin që të shprehim disa fjalë lidhur me performancën e sektorit të shërbimeve të ujit në Kosovë.

Qeveria Zvicerane ka filluar të mbështesë sektorin e ujit në Kosovë në vitin 1999, duke adresuar kryesisht nevojat emergjente. Projektet shpejt kanë kaluar në intervenimet afatmesme dhe afatgjata. Investimet e përgjithshme zvicerane në sektorin e ujit që nga viti 1999, duke përfshirë angazhimet deri në fund të vitit 2017, është rreth 70 milion euro.

Në përgjithësi, siç është thënë në raportin "Trendët e investimeve historike në sektorin e ujit" hartuar nga Këshilli Ndërmindor për ujëra (KNMU) i mbështetur nga SCO, investimet në sektorin e ujit nga viti 1999 deri në vitin 2014 janë bërë në shumën deri në 315 milion Euro nga e cila 2/3 ishin nga komuniteti i donatorëve. Kjo është një shumë e madhe e të hollave, por uji është pjesë esenciale për mirëqenien e popullatës dhe për zhvillimin e përgjithshëm të vendit (bujqësi, energji, etj.). Qasja në ujë është e drejtë njerëzore siç është theksuar qartë në Dokumentin për Politika Ujore e aprovuar në vitin e kaluar. Ne punojmë me OKB-në drejtë arritjes së "Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, përfshirë qëllimin numër gjashtë mbi ujin e pastër dhe kanalizimit.

Qeveria Zvicerane ka mbështetur gati të gjithë sektorët e ujit që kanë të bëjnë me institucionet në Kosovë: KNUMU, Autoritetin rregullator për Shërbime të Ujit, bordet e Kompanive Rajonale të Ujit (KRU), edhe vet KRU-të, Institutin Kombëtar për Shëndetësinë Publike dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës.

Komuniteti i donatorëve beson që ne, së bashku me të gjithë juve, kemi kontribuar shumë në zhvillimin dhe konsolidimin e furnizimit me ujë dhe rritjen e mbulueshmërisë me ujë në mënyrë të konsiderueshme gjatë viteve të fundit për të mirën e popullatës, dhe ky raport tregon se ka trende pozitive në shumicën e treguesve të performancës. Programet rajonale gjithashtu e pranojnë se Kosova ka zhvilluar një qasje relevante për mbulimin e shërbimeve me ujë, përfshirë zonat rurale. Programi i Ujit të Danubit është duke punuar me akterët e Kosovës për të përfutur nga kjo përvojë dhe të ndajnë atë me vende tjera në pellgun e Danubit. Programi i njëjtë e pranon organizimin dhe reformat e sektorit të Ujit të Kosovës, dhe e vlerëson Kosovën si më të mirën në rajon dhe më tej (Ukrainë dhe Moldavi) në kuptim të qëndrueshmërisë të sektorit. Ky është një inkurajim për të gjithë akterët e ujit dhe për komunitetin e donatorëve që ne jemi në rrugë të duhur.

Komuniteti i donatorëve planifikon që të vazhdojë të investojë në këtë sektor, me theks të veçantë në sektorin e ujërave të zeza, duke mbështetur Qeverinë për të avancuar më tej reformat në sektorin e shërbimeve të ujit dhe për të përmirësuar menaxhimin e burimeve ujore.

Megjithatë, e tërë kjo infrastrukturë mund të punojë në mënyrë të qëndrueshme në qoftë se të gjithë ata që marrin shërbime paguajnë për to. Me impiantet e trajtimit të ujërave të zeza, çmimi për metër kub ujë do të rritet në mënyrë të konsiderueshme kështu që KRU-të do të kenë nevojë për mbështetje për të përmbushur me sukses sfidat në të ardhmen. Në anën tjetër ndoshta do të ketë më pak grante nga donatorët në dispozicion në përgjithësi, kështu që paratë duhet të mbledhen diku tjetër: nga konsumatorët, nga qeveria, ose nga sektori privat përmes kredive. Kudo që do të kërkohen të holla mënyrë që të mbledhin fonde KRU-të duhet që të vërtetojnë që ato janë duke u menaxhuar mirë dhe në mënyrë efektive, por që ende kërkohet një përpjekje serioze, duke përfshirë edhe në parandalimin e ndërhyrjeve politike.

Sfidë tjetër për KRU-të janë ndryshimet klimatike, me ngjarjet e mundshme e më ekstreme siç janë përmbytjet dhe thatësira. Thatësira e viteve 2006/07 dhe 2013/14 ishin indikacion se uji i pa-faturuar (UPF) duhet të merret më me shumë seriozitet se në qoftë se humbjet e ujit do të përmirësoheshin, do të ishte e mjaftueshme për t'i përballuar një thatësire të dukshme. Ne besojmë dhe presim që KRU-të të rrisin disiplinën dhe llogaridhënien për të reduktuar në mënyrë të konsiderueshme humbjet e tyre.

Ne jemi të përkushtuar për të vazhduar punën me sektorin e ujit. Ne duam që të mbështesim sektorin për të arritur cilësinë e nevojshme dhe ofrimin e shërbimeve të besueshme në një mënyrë financiarisht të qëndrueshme. Megjithatë, në mënyrë që komuniteti i donatorëve të mbetet i angazhuar është e rëndësishme dhe vendimtare të aplikohen parimet e qeverisjes

së mirë, respektim i procedurave administrative, duke treguar transparencë dhe efikasitet, si dhe ndjekja e praktikave më të mira të menaxhimit.

Me qëllim të përmirësimit të mëtejme të situatës në sektorin e ujit, ne vërtetë duhet të shohim lidhjet mes performancës dhe pagesës së bordeve dhe shefave të KRU-ve. Qeverisja e mirë dhe përmirësimi i performancës së KRU-ve është vendimtare për shërbimet e besueshme. KRU-të duhet në përgjithësi që të jenë në gjendje për të marrë njerëzit e duhur për të punuar, dhe ata nuk duhet të jenë të ngarkuar me staf të panevojshëm dhe të rrezikojnë qëndrueshmërinë financiare. Kosova duhet t'i shmanget rreziqeve që të kthehet në subvencionimin e operimit dhe mirëmbajtjes të kompanive publike të ujit. Sektori është një histori suksesi që ka nevojë të luftoj që të bëhet edhe më i mirë dhe që të mënjanoj praktikatat të cilat mund të kërcënojnë arritjet e deritashme.

Më lejoni që të ju sigurojë se të gjitha angazhimet dhe investimet tona kanë për qëllim që të përfitojë popullata. Uji është një e mirë publike. Kjo e mirë ka nevojë të ndahet në mënyrë të drejtë.

Patrick Etienne

Drejtor, Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë

ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ARRU

Sipas Ligjit 'PËR RREGULLIMIN E SHËRBIMEVE TË UJIT', Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), është institucion i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, me përgjegjësi për rregullimin e veprimtarisë për të gjithë ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë. Në përgjithësi roli i ARRU është për të mbrojtur interesin e konsumatorëve të shërbimeve të ujit, duke i mbajtur faturat sa të jetë e mundur më të ulëta por njëkohësisht duke siguruar qëndrueshmërinë financiare që ofruesit e shërbimeve të mund të kryejnë dhe financojnë të gjitha funksionet e tyre.

Përgjegjësitë specifike të ARRU, janë:

1. **Licencimi i ofruesve të shërbimeve** dhe mbikëqyrja e zbatimit të kushteve të përcaktuara me licencë të shërbimit, duke:
 - poseduar kapacitete profesionale dhe resurse adekuate menaxhuese, operative dhe teknike për operim dhe mirëmbajtje për ofrim të shërbimeve sipas standardeve të shërbimit dhe komerciale,
 - siguruar qëndrueshmëri financiare gjatë tërë kohëzgjatjes së licencës së shërbimit,
 - pranuar përgjegjësinë për ofrim të shërbimeve në tërë zonën e shërbimit të ofruesit të shërbimit, të përcaktuara me politikat dhe planet e qeverisë për konsolidimin e ofruesve të shërbimeve,
 - ju përmbajtur të gjitha kushteve të licencës së shërbimit,
 - siguruar të gjitha lejet, pëlqimet, autorizimet të nevojshme nga autoritetet përkatëse.
2. **Përcaktimi i tarifave të shërbimit** për ofruesit e shërbimeve, duke:
 - siguruar tarifat të jenë të drejta dhe të arsyeshme,
 - siguruar qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve,
 - siguruar që ofruesit e shërbimeve të mund të kryejnë dhe financojnë të gjitha funksionet e tyre,
 - garantuar përmbushjen e standardeve të rrepta të shërbimit të konsumatorëve dhe kerkesave mjedisore,
 - reduktuar sasi të ujit të pa faturuar dhe të pa shitur,
3. **Vendosja e standardeve të shërbimit** dhe mbikëqyrja e zbatimit nga ofruesit e shërbimeve të këtyre standardeve, duke:
 - siguruar se uji i furnizuar është gjithmonë i kualitetit të mirë, me furnizim të vazhdueshëm, si dhe presion adekuat,
 - përmirësuar besueshmërinë, nëpërmjet minimizimit dhe menaxhimit të ndërprerjeve,
 - garantuar se faturat e ujit janë të sakta dhe të jenë pranuar me kohë,
 - mbrojtur konsumatorët ndaj çdo sjellje të keqe dhe abuzive nga ofruesit e shërbimeve,
 - respektuar afatet për zgjidhjen e ankesave dhe kërkesave për lidhje në sistemin e shërbimeve të ujit,
4. **Monitorimi i performancës së ofruesve të shërbimeve** për të vlerësuar nëse ata i përmbushin:
 - standardet minimale të shërbimit të dakorduar me Autoritetin,
 - nivelin në të cilin ofruesit e shërbimeve i përmbushin objektivat e përcaktuara përmes procesit tarifar,
 - sigurinë e funksionimit eficient të ofruesve të shërbimeve dhe sektorit,
 - veprimet korrigjuese që mund të jenë të nevojshme për të përmirësuar gjendjen.
5. **Mbrojtja dhe promovimi i vazhdueshëm i interesave të konsumatorëve**, duke:
 - themeluar dhe mbështetur komisionet këshilluese të konsumatorëve,
 - zgjidhur ankesat e konsumatorëve, të cilat nuk janë trajtuar si duhet nga ofruesi i shërbimeve,
 - mbikëqyrur zbatimin e dispozitave nga aktet ligjore të Autoritetit në lidhje me të drejtat dhe obligimet e ndërsjellta, konsumatorë-ofrues i shërbimeve.

1 HYRJE

Raporti vjetor i performancës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë për 2015, është i 10-të me radhë në serinë e raporteve të publikuara nga Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit dhe paraqet një angazhim të rëndësishëm për të raportuar publikisht dhe në mënyrë të pavarur. Ky është një raport i plotë krahasues i shërbimeve të ujit dhe performancës së ofruesve të shërbimeve(KRU), gjatë dhënies së shërbimeve të ujit. Publikimi i këtij raporti bazohet në përgjegjësinë ligjore të dhënë me Ligjin Nr.05/L-042 për 'Rregullimin e Shërbimeve të Ujit', në kapitullin VII Raportimi dhe monitorimi, gjegjësisht neni 37.

Raporti përmban shumë të dhëna dhe informacione (operative, financiare dhe të nivelit të shërbimeve ndaj konsumatorëve), për 7(shtatë) ofruesit e shërbimeve të licencuara të furnizimit me ujë, shërbimeve të ujërave të zeza, si dhe 1(një) ofrues të shërbimeve të furnizimit me shumicë me ujë të patrajtuar. Në raport paraqiten grafe krahasuese, si dhe tabelat e shoqëruara me komente dhe analiza për rreth 30 tregues për performancën e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit dhe shërbime të ujërave të zeza për vitin 2015 dhe periudhën krahasuese 2014. Treguesit janë përzgjedhur nga një grup më i gjerë prej rreth 100 sish. Ky grup i gjerë i treguesve është në dispozicion në tabelat e bashkangjitura në këtë raport, SHTOJCA 1, të dhënat e detajuara të performancës dhe Shtojca 5-Përmbledhje treguesish të performancës.

KRU ofrojnë shërbimet e tyre në 34 komuna të Kosovës, nga 38 komuna sa janë gjithsejtë. Numri i popullatës së shërbyer nga kompanitë publike të shërbimeve të ujit është mbi 1.45 mil., përdërisa numri total i konsumatorëve është mbi 305,855.

Raporti përbëhet nga katër pjesë qendrore si në vijim:

- Pjesa A, ofron të dhëna për performancën e KRU, të ndarë në katër fusha të veçanta: furnizimi me ujë, shërbimet për ujëra të zeza, performanca financiare e KRU, si dhe vlerësimi i performancës së përgjithshme.
- Pjesa B, jep të dhëna të performancës së përgjithshme të sektorit të shërbimeve të Ujësjetës-Kanalizimit për një periudhë katër vjeçare(2011-2015), përmes disa treguesve kyç të performancës përfshirë: ujin e prodhuar, shitjet dhe UPF, mbulueshmëria me shërbime, të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe paraja e gatshme e arkëtuar, si dhe investimet kapitale për shërbime të furnizimit me ujë dhe ujëra të zeza.
- Pjesa C, ofron të dhëna dhe informacione për performancën e furnizuesit të vetëm të ujit me shumicë, NPH 'Ibër-lepenci', si dhe.
- Pjesa D, e cila përshkruan aktivitetet e KKK dhe vlerëson performancën e tyre, në trajtimin e ankesave të konsumatorëve në regjionet e tyre respektive.

Gjatë përpilimit të këtij raporti, ne kemi vlerësuar të dhënat e ofruara nga kompanitë e licencuara dhe rregulluara nga ARRU dhe kemi përjashtuar ato shërbime të ujit të cilat ofrohen nga skemat (rurale)individuale dhe skemat të cilat nuk janë nën menaxhimin e KRU.

Kemi shfrytëzuar edhe të dhëna tjera të ofruara dhe të publikuara nga institucionet përgjegjëse siç është rasti me të dhënat e raportuara nga IKSHPK(kualiteti i ujit) apo Agjencioni i Statistikave të Kosovës (shkalla e inflacionit, statistikave të popullatës dhe ekonomive familjare).

Pjesa e kualitetit të ujit është komentuar nga IKSHPK, duke u nisur nga fakti se IKSHPK, për herë të parë këtë vit ka publikuar raportin¹ për kualitetin e ujit. Po ashtu me një përmbledhje mbi performancën e sektorit të shërbimeve të ujit në Kosovë me kërkesën e autoriteti ka kontribuar në këtë raport edhe Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (SCO) si një nga Donatorë më kontribut dhënës nga paslufta në sektorin e ujit në Kosovë. Qëllimi i këtij raporti pra është të: pasqyroj trendet e zhvillimit të performancës, të bëjë vlerësimin dhe krahasimin e arritjeve në raport me dakordimin e objektivave me procesin tarifor(2015-2017), si dhe të japë një përmbledhje të të dhënave statistikore të siguruara nga ofruesit e shërbimeve të ujit në vend, gjatë kësaj periudhe të raportimit.

¹ Raporti për cilësinë e ujit të pijshëm në Kosovë për vitin 2015

2 ZHVILLIMET NË SEKTOR

Ligji për Rregullimin e shërbimeve të ujit Nr.05/L-042,

Në muajin dhjetor - 2015, nga Kuvendi i Kosovës, është aprovuar Ligji nr. 05/L -042, mbi Rregullimin e shërbimeve të ujit i cili ka hyrë në fuqi 05.01.2016. Ky Ligj është pasardhës i Rregullores së UNMIKUt 2004/49, mbi veprimtarin e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve dhe mbeturinave, gjegjësisht Ligjit Nr. 03/L-086 për ndryshimin e Rregullores 2004/49. Ligji i ri përveç që ka konfirmuar edhe një herë rolin dhe përgjegjësitë e rregullatorit, i ka definuar edhe më tej disa përgjegjësi si në: fushën e monitorimit, raportimit, inspektimit, si dhe shqyrtimi dhe aprovimi i akteve interne të ofruesve të shërbimeve siç janë: planet e biznesit, menaxhimit të aseteve, investimeve afatgjata, menaxhimit të thatësisë, furnizimit me ujë në situata të emergjencës, si dhe rregulloret dhe procedurat interne të ofruesve të shërbimeve në lidhje me aspektet e veçanta të punës së tyre si rregulloret për: zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve, lidhja e konsumatorëve në shërbime, matjen dhe faturimin, ndërprerjet e shërbimit.

Ligji i ri parasheh disa përmirësime, përdërisa me ligjin e vjetër ndërprerjet kolektive kanë qenë të lejuara në disa raste përfshirë edhe mundësinë e ndërprerjes kolektive për shkak të mospagesës së faturave. Ndonëse ka qenë një procedurë strikte për lejimin dhe monitorimin e tyre nga ana e rregullatorit, këtë mundësi disa prej ofruesve të shërbimeve e kanë përdorur por pa sjellë ndonjë rezultat në qëllimin e aplikimit, megjithëse në shumë raste kjo edhe është keqpërdorur. Tani me ligjin e ri ndërprerjet kolektive nuk janë të lejuara. Ky ligj po ashtu ka paraparë që objektet e kultit të lirohen nga pagesa për shërbimet e ujit. Në këtë lirim nuk përfshihen objektet përcjellëse administrative dhe fitimprurëse.

Zgjedhja e Bordeve të Drejtorëve në KRU

Qeveria e Kosovës përgjatë muajit shtator- tetor 2015, ka zgjedhur bordet e reja të drejtorëve për 6 KRU dhe NPH 'Ibër Lepenci', pronare e të cilave është vetë qeveria. Drejtorët janë zgjedhur për një afat kohor 3 vjeçar për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me ligjin për ndërmarrjet publike Nr. 03L-087, si dhe legjislacionin tjetër përkatës në fuqi. Kjo është gjenerata e dytë e anëtarëve të bordeve për kompanitë përgjegjëse të nivelit qendror. Bordet e kaluara kanë funksionuar që nga viti 2008. Me vazhdimin e mandateve nga qeveria e Kosovës në vitin 2011, po thuajse të gjithë drejtorët në bordet e zgjedhura, janë të rinjë në këto poste. Bordet e drejtorëve të KRU, përbëhen nga gjashtë drejtorë jo ekzekutivë dhe një drejtor ekzekutiv (Kryeshefi ekzekutiv). Gjashtë drejtorët jo ekzekutiv janë zgjedhur nga qeveria, përdërisa drejtorit tjetër, gjegjësisht Kryeshefi ekzekutiv, zgjedhet nga ana e bordit të drejtorëve të NP. Në bazë të ligjit Nr. 03L-087 për ndërmarrjet publike i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në 2008 dhe i ndryshuar e plotësuar në vitin 2012, është vendosur korniza ligjore për rregullimin e ushtrimit të të drejtave pronësore në ndërmarrjet publike, qeverisje korporative të ndërmarrjeve në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare, si dhe janë përcaktuar struktura për mbikëqyrjen e duhur të aktiviteteve të ndërmarrjeve publike. Në këtë ligj po ashtu është paraparë edhe vendosja e bordeve të drejtorëve për këto ndërmarrje, me synimin e udhëheqjes dhe menaxhimit profesional të caktimit të caqeve të zhvillimit të kompanisë, etj. Roli dhe përgjegjësia e bordeve, konsiston në: rritjen e nivelit të llogaridhënies për/nga kompanitë, sigurimin e zbatueshmërisë së ligjit në praktikë, si dhe ndihma për KRU në: rritjen e kultivimit e transparencës, ambientit të duhur të kontrollit dhe mbikëqyrjes, si dhe përmirësimin e performancës operative, financiare dhe shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Grupi Koordinues Ndërinstitucional për Zbatimin e UA nr. 16/2012 për Cilësinë e Ujit

Cilësia e ujit të pijshëm është një prej standardeve më të rëndësishme të shërbimit, e cila duhet siguruar nga ofruesit e shërbimeve, me Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2012 të miratuar nga qeveria e Kosovës në muajin dhjetor të vitit 2012. Praktikisht me nxjerrjen e këtij UA, Kosova ka transpozuar legjislacionin e BE-së sa i përket cilësisë së ujit të pijes. Për zbatimin e këtij UA natyrisht që barrën kryesore e ka Instituti (IKSHP) si autoritet rregullator për cilësinë e ujit të pijes, por gjithashtu edhe institucionet tjera dhe në veçanti furnizuesit e ujit (KRU-të).

Është e qartë se cilësia e ujit të pijshëm mund të garantohet, vetëm nëse do të ketë monitorim efektiv njëkohësisht nga Qendra e ujit (monitorimi jashtëm), si dhe nga KRU, (monitorimi i brendshëm). Në bazë të UA 16/2012 analiza e cilësië së ujit është paraparë të bëhet nga KRU, prandaj ato janë të obliguara të kryejnë analiza të rregullta të cilësisë së ujit, për të siguruar se uji i furnizuar prej tyre përputhet me standardet vendore për ujë të pijshëm. Shumica e KRU edhe pse i kanë

laboratorët dhe bëjnë disa testime bazike, ato ende nuk janë plotësisht të pajisura me staf dhe aparaturë të nevojshme për ti plotësuar kriteret të cilat dalin nga UA. Për ta plotësuar këtë kërkesë ligjore, disa nga KRU (Bifurkacioni, Hidrodrini) kanë bërë kërkesë në Qendrën e laboratorëve testuese të IKSHPK, për të nënshkruar një kontratë për këtë shërbim (monitorimin intern). Po ashtu një numër i tyre janë në fazën e akreditimit të laboratorëve i cili është parakusht për të mundur të kryejnë testime sipas kërkesave të UA.

Zbatimi i këtij UA parasheh një tërësi të aktiviteteve të cilat imponojnë nevojën e një bashkëpunimi/koordinimi ndërinstitucional lidhur me adresimin e kërkesave specifike të përcaktuara me këtë UA, siç janë: konsolidimi institucional i Qendrës së Ujit, miratimi i një sërë standardeve dhe rregulloreve teknike, definimi i procedurave dhe mekanizmave për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut, zhvillimi i sistemit/skëmës për aprovimin e materialeve dhe substancave në kontakt me ujin, mbikëqyrja dhe mbështetja e KRU-ve në procesin e monitorimit intern, si dhe mbrojtja e burimeve ujore.

Duke parë këto aktivitete, si dhe faktin se për më shumë se 2 vite të kaluara prej miratimit të UA Nr. 16/2012, nuk ka pasur një progres substancial në zbatimin e përgjegjësive që dalin nga ky UA. Qeveria e Kosovës, gjegjësisht Këshillit Ndërmintor për Ujëra (KNMU), në takimin e 6-të të datës 1 dhjetor 2015, ka vendosur të themelohet Grupi Koordinues Ndërinstitucional për Zbatimin e UA nr. 16/2012, për Cilësinë e Ujit për Konsum Njerëzor.

Në Grupin Koordinues (GK) ndërinstitucional për cilësinë e ujit janë përfaqësuar të gjitha institucionet qeveritare dhe të tjera që kanë rol në zbatimin e kornizës ligjore dhe rregullatore, me të cilën rregullohet problematika e cilësisë së ujit të pijshëm përfshirë IKSHPK, KNMU, ARRU, MMPH, MTI, MF, MAPL dhe SHUKOS. Së këndejmi grupi ka realizuar një numër të madh takimesh, work shope, tryeza të rumbullakëta të kordinuara nga këshilltari i KNMU, përfshirë edhe takimin inicues ku është themeluar Grupi koordinues, si dhe janë krijuar 6 grupe tematike me qëllim që puna të jetë më efektive.

- Grupi Punues për standardet dhe rregulloret teknike, ka identifikuar dhe ka punuar në standardet dhe rregulloret teknike që me UA nr. 16/2012 kërkohet të hartohen dhe aprovohen.
- Grupi Punues për konsolidimin institucional të Qendrës së Ujit/IKSHPK është angazhuar për adresimin dhe zgjidhjen e problemit të buxhetit dhe organizimit institucional të Qendrës së Ujit pranë IKSHPK.
- Grupi Punues për menaxhimin e rrezikut ka diskutuar dhe propozuar për miratim procedurat për menaxhimin e rrezikut, kur cilësia e ujit nuk i përmbush vlerat parametrike të përcaktuara me UA nr. 16/2012.
- Grupi Punues për aprovimin e produkteve dhe materialeve në kontakt me ujin, është angazhuar në zhvillimin e sistemit për aprovimin e produkteve dhe materialeve në kontakt me ujin.
- Grupi Punues për Monitorimin e Cilësisë së Ujit dhe Raportim, ka adresuar problemet lidhur me monitorimin intern nga ana e KRU-ve (akreditimin e laboratorëve, punësimin e stafit etj.), monitorimin ekstern nga IKSHPK, si dhe raportimin tek qeveria dhe Komisioni Evropian konform UA nr. 16/2012.
- Grupi Punues për Mbrojtjen e Burimeve Ujore, është angazhuar në mbrojtjen e burimeve të cilat shfrytëzohen për pije dhe ka propozuar veprimet e nevojshme ligjore, organizative dhe operative me të cilat do të sigurohej mbrojtje efektive e këtyre burimeve.

PJESA A

PERFORMANCA E KOMPANIVE RAJONALE TË UJËSJELLËSIT-KANALIZIMIT

3. PERFORMANCA INDIVIDUALE E KRU

Kjo pjesë e raportit paraqet dhe diskuton performancën relative të KRU gjatë vitit 2015. Për më tepër, në këtë raport ne prezantojmë vlerësimin mbi performancën individuale dhe të sektorit të shërbimeve të ujit në përgjithësi, si dhe paraqesim trendet e zhvillimit të treguesve të performancës në vitin 2015 në krahasim me vitin paraprak 2014.

Janë shtatë KRU përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit për konsumatorët në Kosovë, të cilat janë ndërmarrje publike dhe nën mbikëqyrjen e qeverisë së Kosovës. Një pjesë e rëndësishme e rolit të ARRU është edhe në monitorimin dhe raportimin mbi punën e KRU, për vlerësimin e arritjeve të performancës dhe efikasitetit në objektivat e vendosura me proceset rregullatore.

Vlerësimi i performancës bazohet në një numër treguesish kryesor të performancës, përfshirë aspektet të cilat lidhen me standardet e shërbimit, performancën teknike, financiare, si dhe vlerësimin e performancës së përgjithshme, ndaras për të dy shërbimet (furnizimi me ujë dhe ujëra të zeza).

Një informacion më të detajuar mbi trendët e zhvillimit, me më shumë të dhëna dhe tregues është dhënë në tabela (Shtojcën 1).

3.1 Furnizimi me ujë

Performanca e furnizimit me ujë është vlerësuar në aspektin e performancës teknike (standardeve të shërbimit, UPF, shërbyeshmërisë së gypave), performancës komerciale (mbulueshmëria me shërbime, matja e ujit, shitjeve sasiore të ujit, ankesave), si dhe performancës financiare dhe kostove (vlera e shitjeve të furnizimit, kostot për njësi dhe shpenzimet kapitale).

3.1.1 Performanca Teknike

Cilësia e ujit

Qendra e Ujit e IKSHPK-së është organi përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm në Kosovë sipas nenit 8 të Udhëzimit Administrativ 16/2012 dhe në pajtim me nenet 4 dhe 7 të Ligjit për Shëndetësinë Publike Nr. 02/L-78 i vitit 2007.

Në raportet e mëhershme vjetore të ZRRUM mbi performancën e Kompanive Rajonale të Ujësjellësit (KRU-ve), përmbledhja performancës së cilësisë së ujit të pijshëm e cila paraqitej ne raportet vjetore të ZRRUM, këtë të fundit jepej nga Qendra e Ujit e IKSHPK-së për përputhshmëri mikrobiologjike dhe kimike për secilën prej KRU-ve. Megjithatë, rezultatet për cilësinë e ujit të pijshëm në dispozicion të IKSHPK-së kanë qenë të kufizuara e veçanërisht nuk e mbulonin një numër të parametrave kimike që janë përfshirë në Udhëzimin Administrativ UA 16/12.

Për vitin 2015, janë vënë në dispozicion nga IKSHPK të dhëna më gjithëpërfshirëse dhe më të besueshme për cilësinë e ujit të pijshëm nga monitorimi i tyre i jashtëm i zonave të furnizimit me ujë të KRU-ve, kryesisht përmes zhvillimeve kryesore në pajisjet analitike të IKSHPK-së, softuer dhe trajnime gjatë viteve të fundit,

Si rezultat i drejtpërdrejtë i zhvillimeve më të larta, IKSHPK kohëve të fundit ka publikuar Raportin e parë Vjetor për Cilësinë e Ujit të Pijshëm në Kosovë për vitin 2015 (më tej në tekst "Raporti Vjetor i IKSHPK-së për Cilësinë e Ujit të Pijshëm (KUP) për vitin 2015").

Prandaj, ky seksion i Raportit Vjetor të ARRU-s për Performancën e Kompanive Rajonale të Ujësjellësit i riprodhon informacionet kyçe drejtpërdrejt nga Raporti Vjetor i IKSHPK-së për KUP-në për vitin 2015.

Përmbledhje e performancës së KRU-ve në cilësinë e ujit të pijshëm për vitin 2015

Në përgjithësi në Kosovë, si rezultat i mbi 43,000 testeve të bëra nga gjashtë laboratorët rajonalë të IKSHPK-së dhe Qendra e Laboratorëve Testuese të IKSHPK-së në Prishtinë gjatë 12 muajve të vitit 2015, shtatë Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit kanë arritur përputhshmëri prej **96.3%** me standardet mikrobiologjike të cilësisë së ujit dhe përputhshmëri prej **97.3%** me standardet kimike, duke rezultuar me një nivel të përgjithshëm të përputhshmërisë prej **97.0%** me standardet e cilësisë së ujit të pijshëm në Kosovë.




Fig. 1, % e përputhshmërisë mikrobiologjike, kimike dhe të përgjithshme me Standardet Rregullative të KUP-së dhe për tërë Kosovën sipas KRU-ve

Megjithatë, edhe mospërputhja prej 1% në mbi 43,000 teste mund të nënkuptojë mbi 400 dështime në arritjen e standardeve kombëtare për ujin e pijshëm dhe ka pasur dallime të konsiderueshme në performancën ndërmjet rajoneve gjatë vitit 2015. Shifrat e dhëna më lartë në këtë raport ilustron se standardet e obligueshme të cilësisë së ujit të pijshëm-veçanërisht standardet mikrobiologjike-nuk arrihen në mënyrë konsistente në Kosovë. Në mënyrë specifike ka pasur mospërmbushje të përsëritur të standardeve mikrobiologjike në vitin 2015, veçanërisht në zonat e furnizimit me ujë të KRU Hidrodrini në Klinë dhe Deçan. Kjo padyshim që nuk është situatë e pranueshme për konsumatorët që shërbehen nga KRU Hidrodrini në këto zona të furnizimit me ujë.

Cilësia e ujit të pijshëm për KRU 'Hidrodrini'. Rezultatet e monitorimit të jashtëm në vitin 2015 për pesë zonat e furnizimit me ujë të KRU Hidrodrini që përfshijnë Pejën (PE), Istogun (IT), Deçanin (DE), Junikun (JU) dhe Klinën (KL) dhe në përgjithësi për KRU Hidrodrini (HD) dhe për Kosovën (KS) janë ilustruar në diagramin më poshtë për standardet mikrobiologjike (ngjyra e kuqe), standardet kimike (ngjyrë e kaltër) dhe nivelet e përgjithshme të përputhjes (ngjyrë e gjelbër). Shih veçanërisht nivelet e ulëta të përputhshmërisë mikrobiologjike për zonën e furnizimit me ujë të Klinës (45.6%).




Fig.2, % e përputhshmërisë mikrobiologjike, kimike dhe të përgjithshme me Standardet Rregullative të KUP-së për zonat e furnizimit të KRU Hidrodrinit.

KRU Hidrodrini, me pjesëmarrjen aktive të Qendrës së Ujit të IKSHPK-së dhe e përkrahur nga këshilltari i KNMU-së, tani është duke ndërmarrë hapa konkret për adresimin e problemeve me cilësinë e ujit të pijshëm në këto zona të veçanta të furnizimit me ujë. Si pasojë e këtyre veprimeve të kohëve të fundit, IKSHPK ka qenë në gjendje të konfirmojë se rezultatet për tre muajt e parë të vitit 2016 tregojnë përmirësime të dukshme në cilësinë mikrobiologjike të ujit të pijshëm në Klinë dhe Deçan, sipas monitorimit të Qendrës së Ujit të IKSHPK-së përmes monitorimit të jashtëm.

Performancën e përgjithshme të cilësisë së ujit sipas zonave të furnizimit .“Elementi” kryesor për menaxhimin dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e ujit të pijshëm nga të gjitha mostrat e ujit të marra nga IKSHPK në pikat e marrjes së mostrave në secilën prej shtatë zonave të furnizimit me ujë të KRU-ve, në bazë të përgjegjësive ligjore të IKSHPK-së për monitorim të jashtëm sipas UA 16/2012, janë zonat e furnizimit me ujë. Këto zona të furnizimit janë përkufizuar në UA 16/2012 si vijon: “Zona e furnizimit është zona e definuar gjeografike brenda të cilës uji që synohet të përdoret për konsum njerëzorë vije prej një apo më shumë burimeve dhe brenda të cilës kualiteti i ujit mund të konsiderohet se është përafërsisht uniform”. Secila KRU pritet të ketë vetëm një numër relativisht të vogël (3-10 max) të zonave (standarde) të furnizimit me ujë në tërë zonën e shërbimit të saj (secila me vëllim mesatar të furnizimit >1000m3/ditë), bashkë me pak zona të tjera “të vogla” të furnizimit (secila zonë me vëllim mesatar të furnizimit <1000m3/ditë).

Tabela 1: Performanca e përgjithshme e cilësisë së ujit të pijshëm publik në Kosovë sipas zonës së furnizimit për vitin 2015

Parametri	Testet në 2015			Numri i zonave të furnizimit–që nuk kanë përputhshmëri
	Teste e bëra	Tejkalimi e përqendrimin ose vlerës së lejueshme në UA 16/2012		
		Numri	%	2015
Total koliform	5003	230	95.4	19
E coli	4991	141	97.2	16
Mbetja e klorit		541	89.0	24
Turbullira	4799	40	99.2	8
Aroma	1760	0	100.0	0
Shija	1760	0	100.0	0
pH	1760	0	100.0	0
Nitratet	1258	100	92.1	9
Nitritet	1563	125	92.0	12
Hekuri	1569	2	99.9	1
Mangani	1306	13	99.0	10
Të gjithë parametrat e tjerë të testuar	12692	92	99.3	19
Total	43365	1284	97.0	

Presioni i Ujit

Definohet si numri i pronave që ndikohen, rregullisht, nga shtypja e ulët. Korniza ligjore e shërbimeve të ujit kërkon nga ofruesit e shërbimeve për të siguruar furnizim me ujë, brenda vlerave parametrike të standardeve vendore për të gjitha pronat në zonën e tyre të shërbimit.

Konsumatorët presin nga furnizuesit e tyre për të siguruar një furnizim me ujë më një presion që është i mjaftueshëm për qëllime familjare (pastrimi, pije, larje dhe gatim).

Presioni i papërshtatshëm mund të ndodh për arsye të kapacitetit të pamjaftueshëm të pompimit ose presioni në rrjeta mbahet i ulët për të minimizuar rrezikun e plasjes se gypave të vjetruara.




Fig. 3, Presioni në rrjetë

Në mesatare 2015, janë raportuar nga shtatë KRU, gjithsejtë 4,430 prona të cilat janë ndikuar nga presioni i ulët, kjo është për 1/3 më shumë se sa ishin në vitin 2014. Kjo është edhe për faktin se këtë vit edhe KRU Mitrovica dhe Bifurkacioni, kanë raportuar të kenë probleme me presion të ulët për një numër pronash, përgjatë zonës së tyre të shërbimit.

Përveç KRU (Bifurkacioni, Mitrovica dhe Hidromorava), kompanitë tjera nuk kanë raportuar apo edhe nuk kanë probleme të mëdha me sigurimin e presionit në rrjetit. Si duket nga fig. 3, KRU 'Bifurkacioni', ka një normë prej 10% apo (2,260) prona me mungesë të presionit adekuat.

Megjithatë, këtë tregues edhe këtë vit duhet marrë me rezerva meqenëse ka vështirësi në përditësimin e të dhënave nga KRU. Rregullatori ka caktuar besueshmëri relativisht të ulët, meqenëse informacionet nuk ruhen në ndonjë sistem të integruar të menaxhimit të rrjetit. Në këtë drejtim është me rëndësi që KRU të zhvillojë një sistem të menaxhimit të presioneve të regjistrimit dhe vlerësimit të aseteve të saj. Vetëm në këtë mënyrë do të jenë në gjendje për t'u marrë me presion të dobët në mënyrë efektive dhe për të synuar mirëmbajtjen dhe zëvendësimin e infrastrukturës në mënyrë efikase.

Vazhdimësia e furnizimit me ujësjellës




Fig. 4, Vazhdimësia e furnizimit me ujë të pijes

Fig. 4, pasqyron normën e konsumatorëve të afektuar nga mungesa e ujit, të ndara në tri kategori, prona: me 24 orë shërbim në ditë, 18-23 orë shërbim në ditë dhe ato me më pak se 18 orë shërbim në ditë.

Janë afro 115,847 konsumatorë nga gjithsejtë 262,321 sish, kryesisht konsumatorë të zonës së shërbimit të KRU (Prishtina dhe Bifurkacioni) të cilët kanë vazhduar të vuajnë nga mungesa e ujit edhe gjatë vitit 2015. Ndonëse edhe tek KRU 'Prishtina', është shënuar pak përmirësim për kategorinë e konsumatorëve të cilët kanë pasur furnizim më pak se 18 orë.

KRU 'Mitrovica' ka përmirësuar dukshëm vazhdimësinë e furnizimit duke rritur numrin (përqindjen) e konsumatorëve të cilët kanë pasur ujë përgjatë 24 orë, po ashtu është zvogëluar edhe numri i konsumatorëve të cilët kanë mungesë të ujit më pak se 18orë/24 orëve të furnizuar nga kjo kompani.

Kryesisht ka qenë mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme prodhuese, si dhe norma e lartë e humbjeve të ujit, dy faktorët kyç të cilat kanë ndikuar që shumica e KRU mos të jenë në mundësi të ofrojnë në vazhdimësi të pandërprerë furnizim me ujë.

Në vitin e fundit ka pasur investime të konsiderueshme në ngritjen e kapaciteteve prodhuese për ujë të pijshëm, investimet domethënëse nga institucionet përgjegjëse vendore dhe ofruesit e shërbimeve të përkrahura nga donatorët ndërkombëtar në zonën e shërbimit të KRU 'Mitrovica', tani më janë ndërtuar dhe lëshuar në përdorim dy fabrika moderne të ujit, një në Mitrovicë (Shipol) dhe tjetra në Komunën e Vushtrisë (Balincë).

Plasaritjet e Gypave

Ky tregues, pasqyron performancën e rrjetit të ujësjellësit përmes numrit të plasjeve të gypave brenda një viti në raport me 100 km gjatësi të rrjetit.




Fig. 5. Plasaritjet e gypave

Plasaritjet e gypave me të cilat janë ballafaquar KRU (matur si numri i plasaritjeve për 100 km të gypit në vit) përgjithësisht, janë të larta në mbi 196 sosh për 100 km gyp në mesatare të sektorit, ndonëse ka një përmirësim të ndjeshëm në raport me vitin paraprak 2014.

Performancën me të dobët, nga të gjitha kompanitë e tjera, kanë treguar rrjeta e ujësjellësit në KRU 'Hidromorava' me 459 për 100 km gyp deri tek ajo me më pak KRU 'Prishtina', me 83 për 100 km gyp.

Si duket një numër kaq i lartë i plasaritjeve (dhe si rrjedhojë edhe humbjeve të larta të ujit), është për shkakun e shpenzimeve të kufizuara në mirëmbajtje kapitale (ripërtëritje infrastrukurore) të rrjetit të furnizimit me ujë.

Uji i pa-faturuar

Uji i Pa Faturuar (UPF), është një masë e ujit të humbur në sistemin e shpërndarjes dhe paraqet diferencë në mes të sasisë së ujit të trajtuar të shpërndarë në rrjetë dhe sasisë së ujit të faturuar. UPF-ja përbëhet nga komponenti i humbjeve teknike (rrjedhjet për shkak të shpërthimeve në gypa apo lidhjeve të dobëta) dhe ajo e humbjeve komerciale (lidhjet e paligjshme, konsumatorët e pa faturuar, humbjet në ujëmatësit e konsumatorëve, etj).

Reduktimi i UPF, nuk është vetëm ekonomikisht e justifikueshme (uljen e kostove operative dhe shpenzimeve kapitale), por edhe e dobishme për KRU dhe konsumatorët në sigurimin e qëndrueshëm të furnizimit me ujë.

KRU kanë një nivel historikisht të lartë të UPF, pa përjashtuar asnjë prej tyre. Rregullatori vazhdimisht përmes proceseve tarifore ka vendosur objektiva vjetore për KRU, për të reduktuar rrjedhjet e ujit.

Objektivat kanë qenë sfiduese por njëkohësisht edhe reale për tu realizuar. Për një planifikim më ambicioz për reduktimin e ujit deri në nivelin ku kostoja e kursimit të reduktimit të UPF është e barabartë me koston ekonomike të ujit dhe atë për një afat kohor optimal, do të duhet të ishte në bashkërendimin e objektivave, si dhe monitorimin e performancës së KRU-ve, së bashku me akterët e tjerë të industrisë së ujit në vend.

Niveli i UPF në praktikën ndërkombëtare vlerësohet dhe diskutohet përmes disa treguesve, gjithnjë për të pasur një pasqyrë sa më të çartë të nivelit të tij. Ne në praktiken tonë kryesisht përdorim 3 tregues vijues: UPF si vlerë sasiore, UPF si litër / konsumatorë në ditë dhe i rregulluar, si dhe UPF i shprehur në përqindje.

UPF si vlerë sasiore në mesatare të sektorit është rreth 77.3 mil.m³, për 1,3 mil.m³ më shumë se sa ishte në vitin 2014.




Fig. 6, Vëllimi i UPF (m³/vit)

Shifrat e tilla tepër të larta të UPF kanë ndikim shumë të madh financiar edhe në aspektet operative të kompanive, sepse rritet kostoja e prodhimit të ujit duke qenë se prodhohet më shumë ujë se sa është e nevojshme, pikërisht për të mbuluar humbjet, nga ana tjetër tek disa KRU shkaktohet deficit në kërkesat për ujë të pijshëm.

Objektiva e përgjithshme e reduktimit të UPF si vlerë sasiore për vitin 2015 përmes procesit tarifor ka qenë në nivelin 64.5mil.m³ kjo objektivë nuk është arritur meqenëse UPF aktualisht është rreth 77.3 mil.m³. Përjashtuar KRU 'Radoniqi' dhe 'Hidroregjioni Jugor', po ashtu asnjë nga KRU edhe në mënyrë individuale nuk kanë arritur të përmbushin caqet në reduktimin e UPF.

UPF litër / konsumatorë në ditë dhe i rregulluar² është njësi më e përshtatshme për krahasimin e performancës, prandaj është përdorur nga ne për të krahasuar performancën e KRU, ky tregues është rregulluar për të marrë parasysht efektet e furnizimit të kufizuar të ndodhura në disa kompani.

² Vlera e UPF për konsumatorë në ditë është përshtatur/rregulluar që të kompensojë orët e shërbimit në ditë.




Fig. 7, UPF si përqindje e prodhimit

Në 2015 disa KRU përfshirë: KRU (Hidrodrini, Hidroregjioni Jugor dhe Radoniqi), kanë shënuar progres sa i përket reduktimit të UPF litër për konsumatorë në ditë. KRU 'Mitrovica' ka shënuar performancën më të dobët, kjo për shkakun e rritjes së prodhimit në raport me numrin e konsumatorëve. KRU 'Mitrovica' duhet në të ardhmen të angazhohet në rritjen e bazës së konsumatorëve dhe zgjerimin e mëtejshëm të shërbimeve, ndonëse në mbulueshmërinë me shërbime të ujësllësit kjo kompani, lënë shumë për të dëshiruar.

UPF i shprehur në përqindje llogaritet si përqindje e sasisë së ujit të shitur në raport me sasinë e ujit të prodhuar, është përdorur sa për ilustrim edhe pse është një tregues i thjeshtë, megjithatë ofron një pasqyrë të shpejtë të UPF.

Janë tri KRU (Hidrodrini, Hidroregjioni jugor dhe Radoniqi) ato të cilat kanë reduktuar UPF në 2015 në raport me vitin 2014. Nivelin më të lartë si përqindje e prodhimit vazhdon ta ketë KRU 'Hidrodrini', ndonëse ka shënuar një rënie të konsiderueshme, kjo me tepër mund ti atribuohet rënies së prodhimit të ujit se sa rritjes së dëshiruar të shitjeve sasiore të ujit

Sido që të jetë UPF mbetet një sfidë e madhe në këtë sektor dhe për të gjitha KRU, pa përjashtim. Niveli i ujit të paturuar në mesatare të sektorit, në raport me ujin e prodhuar dhe distribuuar tek konsumatorët shprehur në përqindje gjatë vitit 2015 është në nivelin 56%, kjo është me e përmirësuar për 2 % në raport me vitin 2014, kur ajo ishte 58%.

3.1.2 Performanca komerciale

Mbulueshmëria me shërbime të ujësllësit

Mbulueshmëria me shërbime të furnizimit me ujë, e definuar si përqindje e popullsisë brenda zonës së shërbimit me qasje në shërbime të sigurta dhe të besueshëm të furnizimit me ujë nëpërmjet lidhjeve në rrjetin publik të furnizimit.

Vlerësimi i mbulueshmërisë me shërbime ka marrë për bazë të dhënat nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës të dala nga regjistrimi i fundit i vitit 2011 për ekonomitë familjare, si dhe numrin aktual të raportuar nga KRU për kategorinë e konsumatorëve aktiv të amvisërisë.




Fig. 8, % e popullsisë në zonën e shërbimit të furnizimit me ujësjellës

Mesatarja në nivel sektori ka shënuar rritje të lehtë nga 84% në 87% në vitin 2015 në raport me vitin 2014. Vetëm katër KRU kanë mbulueshmëri të pranueshme mbi mesataren e sektorit prej 87%.

Niveli i lartë i mbulueshmërisë në KRU 'Prishtina', para së gjithash, duket të jetë për shkak të lëvizjes³ së banorëve nga zonat që nuk janë në zonën e shërbimit të saj. Në aspektin gjeografik të shtrirjes së shërbimeve kryesisht në zonat rurale, KRU 'Prishtina' sh. a. Prishtinë ka ende hapësirë për rritjen e mbulueshmërisë me shërbime.

Shkallën e mbulueshmërisë më të ulët dhe atë dukshëm nën mesataren e sektorit me shërbimet e ujësjellësit, vazhdojnë ta kenë KRU-të(Mitrovica, Hidroregjioni Jugor dhe Hidromorava).

Në bazë të projeksioneve të parapara nga kompanitë, rregullatori ka aprovuar një rritje totale të numrit të konsumatorëve prej 290,263 nga të gjitha kompanitë për vitin 2015. Kjo objektivë është përmbushur si në nivel të përgjithshëm ashtu edhe në shumicën e kompanive. Aktualisht numri i përgjithshëm i lidhjeve, është mbi 305,855 dhe paraqet një rritje në bazën e konsumatorëve për 19,308. në raport me vitin 2014. Më shumë është rritur baza e konsumatorëve në KRU (Prishtina, Bifurkacioni dhe Hidrodrini).

Matja e ujit

Është e drejtë legjitime e konsumatorit që ai të pajiset me ujëmatës, për tu siguruar që ai paguan saktë për ujin të cilin ai e konsumon. Kjo është përgjegjësia e ofruesve të shërbimeve për të siguruar që ujëmatësit janë funksional, të mirëmbajtur rregullisht dhe se faturat janë lëshuar për konsumatorët sipas leximit të ujëmatësit. Nga ana tjetër, kur uji i konsumuar matet, konsumatorët në përgjithësi bëhen më të kujdesshëm me përdorimin e tij. Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës paraqet normën e konsumatorëve të cilët janë pajisur me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve aktivë të shërbyer.

³ Fluksi i madhë i lëvizjes së banorëve nga pjesët e tjera të vendit dhe mos regjistrimi (azhurnimi) i tyre si ekonomi, përkunder regjistrimit si konsumatorë të KRU 'Prishtina'




Fig. 9, % e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës

Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës në nivel sektori në vitin 2015 nuk ka pasuar ndonjë përmirësim, ka mbetur pra në nivel të njëjtë prej 93% sikurse në vitin paraprak 2014. Treguesi i mbulueshmërisë me ujëmatës është dukshëm nën normën e kërkuar ligjore prej 100%.

Krahasuar me 2014 në vitin 2015 mund të vërehet se përqindja e numrit të konsumatorëve me ujëmatës është rritur në katër kompani nga shtatë prej tyre. Rritje më e dukshme në proporcionin e konsumatorëve me ujëmatës mund të vërehet tek KRU ‘Hidromorava’ dhe ‘Hidrodrini’.

KRU ‘Mitrovica’ sh. a. Mitrovicë, ende ka një nivel të ulët të matjes 65%, edhe pse raporti i matjes është përmirësuar për 1% (nga 64% në 65%), por prapë përmirësimi vit pas viti tek kjo kompani është shumë gradual.

Ankesat

Ankesat janë një prej çështjeve më kritike për matjen e kënaqësisë së konsumatorëve. Ata kanë të drejtë për t'u ankuar nëse nuk e marrin shërbimin e garantuar brenda standardeve vendore. Nga ana tjetër ofruesit e shërbimeve janë të detyruar që të mbajnë një regjistër të ankesave të konsumatorëve, si dhe zgjidhjen e tyre brenda afateve kohore ligjore. Një ulje e numrit të ankesave mund të tregojë përmirësim në shërbim dhe / ose që konsumatorët po humbasin besimin në ofruesit e tyre, prandaj vendosin për të mos u ankuar.




Fig. 10, Numri i ankesave në shërbimet e ujësjellësit

Siç tregohet në figurën 10, numri total i ankesave në 2015 është 17,153 kjo shifër është për 2,423 e ankesave të regjistruara më pakë në 2015. Rezultati i përgjithshme është se ankesa ka pasur më pakë për rreth 12%, se sa në vitin paraprak 2014.

KRU 'Prishtina' si kompani me numër më të madh ankesash ka raportuar zbritje të konsiderueshme në ankesat e natyrës komerciale përgjatë 2015 në raport me vitin 2014, përderisa numri i ankesave teknike në KRU 'Prishtina' është rritur.

Rritjen më të lartë në numrin e ankesave e kanë shënuar KRU (Hidromorava, Radoniqi dhe Hidrodriini). Për ndryshim nga viti i kaluar norma e ankesave për 1000 konsumatorë në nivel të sektorit po ashtu ka rënë nga 68 në 56 ankesa për 1000 konsumatorë. Shkallën më të lartë të ankesave në proporcion me numrin e konsumatorëve e mbajnë KRU 'Hidromorava', si dhe KRU 'Prishtina'.

Pjesa më e madhe e ankesave teknike në furnizim me ujë të raportuara nga KRU, ishin të lidhura me operative (ndërprerje, mungesë presioni dhe rrjedhje të ujit), përderisa sa i përket aspektit financiar (komercial), konsumatorët më tepër janë ankuar në aspektet të cilat lidhen me borxhet (kontestim të borxhit, zbritja shlyerja e borxhit), si dhe faturimit (faturimi paushall apo faturimi i lartë).

Volumi i ujit të shitur

Volumi i ujit të shitur paraqet normën e ujit të është shitur në raport me shitjet e planifikuara nga KRU.




Fig. 11. Vëllimi i ujit të shitur si përqindje e vëllimit të shitjeve të planifikuara

Figura 11, paraqet nivelin e përbushjes së objektivave të shitjeve sasiore të ujit në krahasim me vlerësimet e planifikuara ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU për procesin e rishikimit tarifor (2015-2017) për vitin 2015 dhe në raport me vitin paraprak 2014. Nga fig. e mësipërme po ashtu shihet se asnjë nga KRU nuk i kanë arritur objektivat e shitjeve të planifikuara, përkundrazi niveli i përbushjes në vitin 2015 në raport me vitin 2014 ka shënuar rënie, përjashtuar KRU 'Radoniqi' e cila ka arritur në rastin më të mirë nga të gjitha KRU të përbush planifikimin në nivelin prej 95%.

Në mesatare të sektorit përbushja e caktuar është në nivelin 85%, kjo është më e ultë për 4% në krahasim me vitin 2014, kur niveli i përbushjes së shitjeve sasiore të ujit ishte 89%.

Mos realizimi i objektivave të shitjeve sasiore nga ana e KRU do të këtë ndikim në të ardhura të pamjaftueshme nga shitjet për të përbushur nevojat financiare të tyre, në veçanti për financimin e mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes infrastrukture.

3.1.3 Performanca Financiare⁴

Në këtë nën-seksion të raportit janë vlerësuar treguesit financiar përmes të cilëve është pasqyruar qëndrueshmëria financiare e KRU në: faturim, kostot operative dhe kapitale për shërbimin e furnizimit me ujë.

Vlera e shitjeve (EUR)

Vlera totale e shitjeve të ujit është një tregues i rëndësishëm i performancës financiare përmes të cilës mbulohen shpenzimet operative dhe mirëmbajtja kapitale. Rreth 88% e të hyrave të KRU realizohen nga shërbimet e furnizimit me ujë. Pra, janë të ardhurat që KRU kanë marrë për sigurimin e furnizimit me ujë duke përjashtuar të ardhurat e tjera ad-hoc, të cilat ato kanë mundur ti realizojnë.

Niveli i realizimit të shitjeve (faturimi) për shërbimet e ujit në raport me objektivat e aprovuara me BPRR (2015-2017) për vitin 2015, është paraqitur në fig.12.




Fig. 12, Vlera e shitjeve të furnizimit me ujë, në raport me planifikimet

Si në nivelin individual të KRU ashtu edhe në nivel të përgjithshëm mesatar ka vazhduar trendi i mos realizimit të projeksioneve në vlerën e shitjeve. Vlera totale e projektuar e shitjeve në 2015 ka qenë rreth 31mil.€, përdërisa janë realizuar 27.1mil.€ apo 88% dhe kjo është më e ultë për 2% nga ajo e cila ishte arritur në vitin 2014⁵.

Ne vitin 2015 të gjitha KRU kanë mundur të faturojnë 27.1 mili. € dhe kjo është më e lartë për 1,97mil.€ apo 7.81%, krahasuar me vitin 2014.

Planifikimet në vlerën e shitjeve në BPRR natyrshëm janë në rritje vit pas viti nga KRU. Për vitin 2015 pritjet për shitje kanë qenë më të larta për 10% në raport me vitin 2014. Mos realizimi i shitjeve të ujit para së gjithash është rezultat i jo efikasitetit të KRU për ti rritur shitjet sasiore.

Performanca e shitjeve në nivel të kompanive në rastin më të mirë edhe këtë vit është ajo e KRU 'Bifurkacioni' me përqindjen me të lartë të caktuar të arritur (96%), për tu pasuar edhe nga KRU 'Radoniqi', me arritshmëri të caktuar 95% dhe progres prej 5% krahasuar me vitin paraprak. KRU 'Mitrovica', si rast më i keq, ka arritur vetëm 78% të caktuar të synuar edhe pse është raportuar rritje e prodhimit prej 18%, duke reflektuar pastaj tek shitjet e ujit në m³ prej 15% krahasuar me vitin 2014.

Fig. 13, pasqyron trendet e vlerës së shitjeve të realizuara gjatë periudhës raportuese 2015 në raport me vitin 2014.

⁴ Të gjitha vlerat financiare të shprehura në euro, janë rregulluar sipas çmimeve bazë për vitin 2015, për të siguruar krahasime të duhura nga viti në vit.

⁵ Viti 2014 është viti bazë i procesit tarifar 2015-2017 dhe ndryshon nga viti paraprak i paraqitur ne Raportin e Performancës 2014.




Fig. 13, % e vlerë së shitjeve të ujit gjatë vitit 2015 në raport me ato në vitin 2014.

Të gjitha kompanitë kanë shënuar progres në vlerën e shitjeve të ujit. KRU “Bifurkacioni” ka realizuar shitjet më të larta për rreth 22.47 në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014.

Si rezultat i rritjes së shitjeve volumetrike në vitin 2015 për 19% në vlerë absolute shitjet në përgjithësi në 2015 në raport me 2014, janë më të larta për 7.81%.

Kostot për njësi⁶

Kostoja e operimit është një çështje shumë kritike në ofrimin e shërbimeve. Shpenzimet e operimit kryesisht lidhen me shpenzimet e personelit, të energjisë, mirëmbajtjen, kemikaleve, si dhe shpenzimet administrative, këto kanë një ndikim të madh në efikasitetin e një kompanie. Këto janë analizuar nga ARRU gjatë procesit të aprovimit të tarifave dhe janë rregulluar në mënyrë që të parandalojë që shpenzimet e pajustificuara të kalojnë te konsumatorët.

Kostoja e prodhimit për njësi e ujit të prodhuar është tregues i rëndësishëm financiar në bazë të cilës vlerësohen shpenzimet operative për prodhim të një (1)m³ ujë.




Fig. 14, Kostoja për njësi e ujit të prodhuar në 2015 në raport me vitin 2014

Kostoja mesatare e një njësie uji të prodhuar në vitin 2015 nuk ka pësuar ndryshim krahasuar me vitin 2014 d.m.th., ka mbet e njëjtë me 0.045€/m³.

⁶ Kostot për njësi për vitin paraprak 2014 janë të rregulluara me normë të inflacionit 0.99461 (indeksi:2015/2014)

Kostoja e prodhimit të ujit në të shtatë KRU është e ndryshme dhe varion nga ajo më e ulëta 0.06 €/m³, tek KRU ‘Hidrodrini’, deri të ajo më e larta me 0.08 €/m³ në KRU ‘Hidroregjioni Jugor’.

Kostoja e prodhimit ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga lloji i burimit të furnizimit, (sipërfaqësor apo nëntokësor), dhe mënyra e kaptimit të ujit p.sh. kaptimi me gravitet është më i lirë të operohet se sa sistemi me pompa, mandej burimi i shfrytëzuar me cilësi të mirë dhe sasi të bollshme të ujit të pa përpunuar po ashtu zvogëlon dukshëm koston e prodhimit, siç është rasti i KRU ‘Hidrodrini’, apo në rastin tek kostoja më lartë e ujit të prodhuar nga KRU ‘Hidroregjioni Jugor’, e cila është e ndikuar nga shpenzimet e larta për trajtimin e ujit në veçanti nga shpenzimet e energjisë dhe derivateve gjatë funksionimit të pompave.

Kostoja totale për njësi e furnizimit me ujë paraqet shpenzimet totale, përfshirë shpenzimet operative dhe shpenzimet për mirëmbajtje kapitale të aktivitetit biznesor për furnizim me ujë, përjashtuar kthimin në kapital dhe borxhet e këqija, të gjitha në raport me volumin e ujit të shitur për të njëjtën periudhë raportuese.




Fig. 15. Kostoja për njësi e furnizimit me ujë,(€ për m³ ujë të shitur)

Në vitin 2015 në nivel të sektorit kostoja për njësi e furnizimit me ujë ka qenë 0.39 € për m³ dhe është më e ulët për 0.01 € për m³, krahasuar me vitin paraprak .

KRU ‘Hidrodrini’, në raport me kompanitë e tjera ka nivel dukshëm më të ulët të koston(0.24 €/m³), duke qëndruar në pozitë të njëjtë krahasuar me vitin paraprak. KRU ‘Prishtina’ ka koston më të ulët në krahasim me vitin 2014, e cila ka arritur ta zvogëlojë koston nga 0.50 në 0.45 si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale për shërbimet e ujit për 47% (zvogëlimi i shpenzimeve operative, do kishte qenë me e pranueshme).

Kostot në vitin 2015 në raport me vitin 2014 në shumicën e kompanive kanë qenë më të larta, por rënia e koston të KRU ‘Prishtina’ dhe KRU ‘Hidroregjioni Jugor’, ka ndikuar që sektori të këtë trend pozitiv në këtë vit.

Kostoja totale për njësi e furnizimit me ujë e realizuar në raport me atë të planifikuar,

Po ashtu është një tregues financiar i cili radhitet në grupin e treguesve kryesor, si i tillë ka ndikim në performancën e furnizimit me ujë. Ky tregues paraqet kostot për njësi të furnizimit me ujë të realizuara në raport me kostot e planifikuara për njësi të furnizimit me ujë.




Fig. 16, Kostoja për njësi e furnizimit me ujë në raport me kostot e planifikuara për njësi

Përbushja e kostove të planifikuara për njësi që rrjedhin nga rishikimi tarifor 2015-2017 (të rregulluara sipas niveleve të çmimeve në 2015), tek të gjitha KRU ishin më të larta se sa ato të planifikuara, megjithatë kjo nuk tregon një performancë të mirë, për arsye se kostot e planifikuara për njësi kanë përfshirë shpenzime të konsiderueshme për ripërtëritjen infrastrukurore dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale për asetet e reja e që nuk kanë ndodhur ti realizojnë ato as 36% të tyre, duke tejkuluar mandej shpenzimet operative për 7% .

Në nivel të sektorit përbushja e objektivave të kostove për njësi e furnizimit me ujë në 2015 edhe më tej ka devijuar nga objektiva e planifikuar prej 90%, por krahasuar me vitin paraprak është përmirësuar për 8% nga 123% në 116%.

Shpenzimet kapitale për ujë

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale të realizuara për mirëmbajtje dhe rritje kapitale në shërbimet e ujit në raport me shpenzimet kapitale të aprovuara në planin e biznesit për vitin 2015 sipas procesit tarifor 3 (2015-2017).

Për vitin 2015, KRU kanë paraparë shpenzime të konsiderueshme rreth 33,4 milion €, për rritje kapitale dhe mirëmbajtje kapitale për shërbime të ujit, këto mjete janë paraparë të sigurohen si nga mjetet vetanake ashtu edhe nga donacionet. Në realitet, shpenzimet aktuale ishin shumë më të ulëta se niveli i pritur dhe atë prej 4,9 milion€ apo 15% nga ajo që ishte planifikuar gjatë procesit tarifor (2015-2017).

Investimet e realizuara kanë vazhduar të jenë kryesisht nga grantet, (donacionet zhvillimore) pa përjashtuar të gjitha kompanitë që kapin vlerën prej 3 mil.€ apo 62% nga totali i investimeve, ndërsa më pak investime janë bërë nga mjetet vetanake dhe atë prej 1,8 mil.€ apo 38%.




Fig. 17, Shpenzimet kapitale për furnizim me ujë

Nga Biznes Planit vërehet se për vitin 2015, % më e lartë e investimeve nga totali, kanë qenë të planifikuara nga KRU 'Prishtina' 16,97 milion€, përderisa janë realizuar 0.9 milion€ apo 5.5%. Kompanitë e tjera, kanë paraparë investime në shërbimin e furnizimit me ujë, të cilat varionin nga 0.2 deri 6 mil.€. Siç vërehet nga fig. 17, investimet e deklaruara nga KRU 'Hidrodrini' ishin shumë më të larta se sa ato të planifikuara në BPRR, të cilat ishin kryesisht investime nga donatorët (grante) dhe atë 88%, se sa që ishin të financuara nga burimet vetanake financiare.

Shumat e buxhetuara nga KRU vazhdojnë të jenë shumë më të ulëta se investimet e planifikuara të cilat edhe janë mbuluar nga tarifat e aprovuara. Megjithatë është inkurajuese fakti se orientimi i KRU në vitet e fundit është me dedikimin për mirëmbajtje kapitale. Kjo me siguri se do të rezultojë në mënyrë efektive në përmirësimin e bazës së aseteve dhe të niveleve të shërbimit.

Tabela 2, Vlera e investimeve në shërbimin e ujit

Realizimi i investimeve në shërbimet e ujit nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2015				
Kompania	Inv. në prodhim	Inv. në distribuim	Inv. në aktivitete biznesore	Totali
Prishtina	106,990	343,822	488,996	939,808
Hidroregjioni Jugor	124,173	144,553	25,847	294,573
Hidrodrini	1,695,000	72,006	172,866	1,939,872
Mitrovica	0.00	0.00	0.00	0.00
Radoniqi	762,643	387,927	113,850	1,264,420
Bifurkacioni	77,326	157,376	28,785	263,487
Hidromorava	22,884	170,144	10,418	203,446
Totali	2,789,016	1,275,828	840,762	4,905,606

KRU 'Hidrodrini' ka realizuar shpenzimet kapitale më të lartat nga të gjitha kompanitë e tjera, prej 1,9 mil.€ (ndërtimin e fabrikës së ujit në Klinë, vendosjen e ujëmatësve, ndërtimi i objektit të aktivitetit biznesor etj.). Me këto shpenzime, është synuar të përmirësohet vazhdimësia e furnizimit me ujë, të përmirësohet shërbyeshmëria e infrastrukturës dhe ngritja e nivelit të standardeve të shërbimeve.

KRU 'Radoniqi' në raport me kompanitë mbetet në rendin e dytë për realizim të investimeve, por sa i përket raportit me investimet e planifikuara nuk ka arritur as 30% të tyre të realizoj, megjithatë pjesa e investimeve të realizuara kanë qenë kryesisht në prodhim dhe atë në: ndërtim të kanalit derivues, ndërtime të objekteve, pastaj në distribuim: ndërtimin dhe ndërrimin e rrjetit të ujësjellësit, vendosjen e ujëmatësve etj.

Kompania e cila nuk ka realizuar fare investime ka qenë KRU 'Mitrovica', edhe pse ajo sipas BPRR për vitin 2015 kishte planifikuar investime në vlerë prej 3,9 mil. €. Nga kjo kompani janë pritur të bëhen investime të konsiderueshme në projektet e zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit në 12 fshatra në Komunën e Skënderajit dhe 24 fshatra në Komunën e Vushtrrisë, zëvendësimi i gypave në Mitrovicë dhe Vushtri, Instalimi i ujëmatësve të rinjë për konsumatorët pa ujëmatës, e projekte tjera.

Ndikimin kryesor për mos përmbushjen e investimeve të planifikuara në lartësinë e aprovuar, mund ti atribuohet mos realizimit të objektivave të faturimit dhe të arkëtimit, si dhe rritjes së shpenzimeve operative, duke rezultuar me mungesën e mjeteve aq të nevojshme për investime kapitale.

⁷Ndryshon nga Biznes Planit për vitin 2015 meqenëse është e rregulluar me normë të inflacionit

3.2 Shërbimet për ujëra të zeza

3.2.1 Performanca teknike

Frekuenca e bllokimit të kanalizimit

Treguesi i besueshmërisë së grumbullimit të ujërave të zeza, bëhet përmes vërshimeve në kanalizim (ose bllokimeve) për 100 km të gypave në vit. Bllokimi i kanalizimit mund të ndodhë kur në sistemin e kanalizimit rrejtë i gypave dështon, për shkak të dëmtimit, mospastrimit ose kur vëllimi i reshjeve të cilat hyjnë në kanalizime e tejkalon kapacitetin e saj absorbues.




Fig. 18. Numri i bllokimeve të kanalizimit për 100km

Fig 18, tregon një gamë të ndryshme të performancës së sistemit të kanalizimit të KRU. Nga 133 bllokime tek KRU 'Hidrodrini', deri tek KRU 'Radoniqi', e cila ka raportuar 945 bllokime / vërshime për 100km të rrjetit.

Në nivel mesatar trendi i bllokimeve të kanalizimit është në përmirësim, megjithatë niveli prej 510 bllokime / vërshime për 100km të rrjetit është tepër i lartë. Në nivel vendor dhe ndërkombëtar nuk ka pikë reference që tregon një performancë të kënaqshme, por sipas hulumtimeve tona paraprake arrihet në konkludim se një rrjet i mirë funksionues i kanalizimeve nuk duhet të ketë më shumë se 100 bllokime / vërshime për 100 km të gypave në vit.

Si duket shkaqet për një nivel kaq të lartë të bllokimeve është neglizhenca dhe mirëmbajtja jo adekuate e sistemit të kanalizimit dhe po ashtu viti 2015 ka qenë i karakterizuar me një mot me reshje i cili ka shkaktuar edhe vërshime të herë pas herë në pjesë të ndryshme të vendit.

KRU duhet të kenë qasje më pro aktive në pastrimin dhe riparimin e rrjetit. Ato duhet që në përputhje me obligimet ligjore⁸ të bëjnë inspektimin, si dhe pastrimin e tërë sistemit të kanalizimit.

3.2.2 Performanca komerciale

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të zeza(kanalizimi)

Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit është e definuar si përqindje e popullsisë, brenda zonës së shërbimit që kanë shërbime të kanalizimit.

⁸ Rregulla për standardet minimale të shërbimit të ujit në Kosovë kërkon nga KRU që: njëherë në dy vite, të inspektojë çdo pusetë të Rrjetit të Ujërave të Zeza si dhe së paku një herë në pesë (5) vite, të bëhet pastrimi i tërësishëm i rrjetit të ujërave të zeza.




Fig. 19, Mbulueshmëria me shërbimet e ujërave të zeza

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të zeza në nivel sektori sikurse edhe tek shërbimi i furnizimit me ujë ka shënuar progres të lehtë për të arritur në nivelin 65% në vitin 2015.

Janë shumica e KRU të cilat kanë mbulueshmëri me shërbime të kanalizimit rreth 50%, sidomos është brengosëse gjendja në KRU ‘Hidrodrini’ e cila vazhdon të këtë hapësirë të konsiderueshme për përmirësim.

KRU ‘Prishtina’ dhe ‘Bifurkacioni’, janë dy nga gjithsej shtatë KRU, me një nivel të pranueshëm të mbulimit me shërbime të kanalizimit, e para me mbi 89% dhe e dyta me 80%.

Ankesat

Treguesi në vijim paraqet numrin e ankesave që konsumatorët i adresojnë tek kompanitë e tyre, në lidhje me shërbimin e ujërave të zeza (kanalizimit).




Fig. 20, Ankesat për shërbimet e ujërave të zeza

Nga fig. e mësipërme shihet se gjatë vitit 2015 numri i ankesave të konsumatorëve në shërbimin e ujërave të zeza është në rritje. Në total kanë qenë gjithsejtë rreth 7,943, ankesa kryesisht në aspektet teknike të shërbimit (bllokime, vërshime, dëmtime, etj). Kjo rritje e numrit të ankesave më tepër lidhet me azhurnimin e ankesave të konsumatorëve e cila ka ndikuar në rritjen e besimit në atë se kompania do të zgjidh problemet e tyre, pasi ata të jenë ankuar. Edhe pse tek frekuenca e bllokimit të kanalizimit ka pakë përmirësime, konsumatorët ende kanë shumë arsye për tu ankuar, meqenëse deri tek arrija e standardeve të pranueshme në këtë shërbim ka hapësirë shumë për tu dëshiruar.

Nga tri KRU (Mitrovica, Hidromorava dhe Hidrodrini), numrin më të madh të ankesave për shërbimin e ujërave të zeza e ka KRU 'Mitrovica', tek kjo kompani ka vazhduar trendi në rritje i numrit të ankesave në 2015, në raport me vitin 2014.

Edhe KRU 'Hidromorava' si dhe ajo 'Hidrodrini', po ashtu kanë numrin më të madh të ankesave nga kompanitë e tjera, megjithatë është evidentuar një trend afërsisht i njëjtë në dy vite (2014-2015).

3.2.3 Performanca financiare⁹

Në këtë nën-seksion të raportit, janë vlerësuar treguesit financiar përmes të cilëve është pasqyruar qëndrueshmëria financiare e KRU, siç janë: shitjet, kostot operative dhe kapitale për shërbimin e ujërave të zeza.

Vlera e shitjeve e shërbimeve të ujërave të zeza (EUR)

Figura 21, si me poshtë paraqet, performancën e shitjeve të shërbimeve të ujërave të zeza, në krahasim me vlerësimet e planifikuara ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU, në procesin tarifor 2015-2017.




Fig. 21, Shitjet e ujërave të zeza në raport me planifikimet

Për shkak të nën-performancës së konsiderueshme të shitjeve aktuale të ujit krahasuar me shitjet e planifikuara, vlera e shitjeve aktuale në shërbimet e ujërave të zeza, gjithashtu është nën vlerat e planifikuara pasi që është drejtpërdrejtë e lidhur me volumet e shitjeve të ujit.

Shumica e kompanive nuk kanë mundur të arrijnë objektivat e shitjeve të ujërave të zeza gjatë vitit 2015, madje ato janë me të ulëta se sa ishin në vitin 2014, me përjashtim të KRU 'Radoniqi' dhe 'Hidromorava' të cilat madje i kanë tejkaluar objektivat e planifikuara.

Përbushja e objektivës në nivel të sektorit për 2015, ishte në nivel prej 91%, kjo është për 3% më e lartë nga ajo që ishte në vitin 2014.

KRU 'Radoniqi' ka arritur përqindjen më të lartë të përbushjes së objektivës së shitjeve në krahasim me vitin e kaluar krahasuar me kompanitë e tjera për 20%. Po ashtu KRU 'Bifurkacioni' e ka përmirësuar normën e shitjeve të ujërave të zeza për 19%.

Vlera relative e shitjeve të shërbimeve të kanalizimit

Figura 22, pasqyron trendet e vlerës së shitjeve të realizuara, gjatë periudhës raportuese 2015, në raport me vitin 2014.

⁹ Sikurse për raportimin e performancës për furnizimin me ujë të gjitha vlerat e shprehura në euro, janë të rregulluara sipas çmimeve bazë për vitin 2015.

Vlera relative e shitjeve të shërbimeve të kanalizimit për 2015 në raport me 2014




Fig. 22, Vlera relative e shitjeve të shërbimeve të kanalizimit gjatë 2015 në raport me vitin 2014

Vërehet edhe nga fig.22, se me përjashtim të KRU 'Hidrodrini' të gjitha kompanitë tjera kanë shënuar progres në shitjen e shërbimeve të ujërave të zeza gjatë vitit 2015 krahasuar me vitin 2014. Sikurse të shërbimet e ujit edhe këtu prin KRU 'Bifurkacioni' me shitjet më të larta për 42%, rritje e lartë, e cila është reflektuar nga rritja e numrit të konsumatorëve në shërbimet e ujërave të zeza për 15%, duke ndikuar pastaj edhe në rritjen e shitjeve volumetrike për 58%.

Në nivel të përgjithshëm në vitin 2015, shitjet janë më të larta për 15.22% se sa ishin në vitin 2014.

Kostot totale për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza të realizuara në raport me planifikimet

Ky tregues paraqet raportin në mes kostos për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza të realizuara (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/me ekuivalentet e konsumatorëve shtëpiak) dhe kostos për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza të planifikuara (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/ ekuivalentet e konsumatorëve shtëpiak).

Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza në raport me kostot e planifikuara për njësi




Fig. 23, Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza në raport me kostot e planifikuara për njësi

Kostot e planifikuara për njësi që rrjedhin nga rishikimi tarifor 2015-2017 (të rregulluara sipas niveleve të çmimeve në 2015), gati në të gjitha KRU ishin më të ulëta se sa ato të planifikuara. Edhe pse KRU 'Hidroregjioni Jugor' dhe KRU 'Mitrovica' në krahasim me kompanitë e tjera kanë arritur përqindjet më të larta të realizimit nga caku i planifikuar, prapë nuk kanë treguar performancë të mirë, për arsye se kanë tejkaluar shpenzimet operative për 102%, përkatësisht 76%.

Në nivel të sektorit përbushja e objektivave të kostove për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza në 2015, është përmirësuar për 16% nga 52% në 68%.

Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të zeza

Kostot për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza janë të definuara si kosto vjetore (shpenzimet totale operative për ujëra të zeza, përfshirë mirëmbajtjen kapitale të ujërave të zeza) në raport me konsumatorët shtëpiak të shërbyer¹⁰.




Fig. 24, Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza

Në vitin 2015, në nivel të sektorit kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza ka qenë 5.98 €/kons. dhe është për 1.32 €/kons. më e lartë krahasuar me vitin 2014.

Përveç KRU 'Prishtina' dhe KRU 'Radoniqi' të cilat në vitin 2015 kanë treguar trende pozitive me një rënie prej 1.48€ (Prishtina) dhe 1.92 (Radoniqi), të gjitha kompanitë tjera kanë shënuar trende negative në këtë tregues.

Rritja e kostove për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza në përgjithësi, mund t'i atribuohet rritjeve të dukshme të shpenzimeve totale operative dhe shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale, në shumicën e KRU, në veçanti rritjes së shpenzimeve për trajtimin e ujërave të zeza të KRU 'Mitrovica'.

Koston më të ulët në këtë tregues e ka KRU 'Prishtina', 1.64 €/kons. si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve operative për shërbimet e ujërave të zeza.

Kostot për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza në Kosovë, janë shumë të ulëta në krahasim me kostot e shërbimeve të ujërave të zeza në vendet evropiane për shkakun e mungesës së trajtimit të ujërave të zeza.

Kjo do të jetë edhe për pak kohë duke marrë parasysh nevojën dhe paralajmërimet për përmirësimin e konsiderueshëm të shërbimeve të ujërave të zeza në Kosovë, e sidomos me futjen në përdorim të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza, si dhe zgjerimin e rrjetit të shërbimeve.

Shpenzimet kapitale për ujëra te zeza

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale të realizuara për mirëmbajtje dhe rritje kapitale në shërbimet e ujërave të zeza në raport me shpenzimet kapitale të aprovuara në planin e biznesit.

¹⁰ Konsumatorët shtëpiak të shërbyer definohe si numri aktual i konsumatorëve shtëpiak plus numri konsumatorëve jo shtëpiak të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiak bazuar në ndarjen proporcionale të ujit të konsumuar.




Fig. 25, shpenzimet kapitale në shërbimin e ujërave të zeza në raport me planifikimet

Sikurse të shërbimet me furnizim me ujë, kompanitë për vitin 2015, kanë paraparë provizionime të konsiderueshme rreth 12.8 milion € për rritje kapitale dhe mirëmbajtje kapitale në shërbimet e ujërave të zeza, të parapara të sigurohen si nga mjetet vetanake ashtu edhe nga donacionet, por në realitet shpenzimet aktuale ishin shumë me të ulëta se niveli i pritur, dhe atë prej 1 milion ose 7.98% nga ajo që ishte planifikuar gjatë procesit tarifar 2015-2017.

Është evidente se shumica e investimeve të realizuara janë nga donacionet, prej 949,192€, ndërsa pjesa tjetër është nga të hyrat vetanake gjithsejtë 75,428€ .

Nga mjetet vetanake të planifikuara të shpenzohen në shërbimin e ujërave të zeza në shumë prej 843,700on € dhe të cilat janë mbuluar nga tarifat e aprovuara, janë realizuar vetëm 75,428€ apo 9%.

Tabela 3, Vlera e investimeve në shërbimin e ujërave të zeza

Realizimi i investimeve në shërbimet e ujërave të zeza nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2015					
KRU	Inv.në grumbullim	Inv.në trajtim	inv.në shkarkim	inv.akt. biznesore	Totali
Pristina	0.00	6,196.00	0.00	15,123.00	21,319.00
Hidroregjioni Jugor	1,085.00	852,313.00	0.00	3,195.00	856,593.00
Hidrodrini	69,772.00	0.00	0.00	19,208.00	88,980.00
Mitrovica	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Radoniqi	36,950.00	0.00	0.00	5,136.16	42,086.16
Bifurkacioni	8,108.00	0.00	0.00	6,752.00	14,860.00
Hidromorava	0.00	0.00	0.00	782.00	782.00
Totali	115,915.00	858,509.00	0.00	50,196.16	1,024,620.16

Sa i përket investimeve të realizuara në shërbimet e ujërave të zeza prin KRU 'Hidroregjioni Jugor' me 84%, të shumës totale të investimeve (1,024,620€), të cilat kryesisht kanë qenë të orientuara në zgjerim të infrastrukturës dhe jo infrastrukturës për trajtimin e ujërave të zeza. Shumica e KRU nuk kanë arritur as 10% të vlerës totale të investimeve të investojnë në shërbimin e ujërave të zeza.

KRU 'Hidrodrini' dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor' kanë realizuar investimet e planifikuara në nivelin 36%, përkatësisht 12.8%. Brengosëse është situata me KRU "Radoniqi" e cila ka planifikuar shpenzime domethënëse kapitale në shërbimin e ujërave të zeza e prej të cilave ka realizuar vetëm 0.8% .

3.3 Performanca financiare e KRU

Arkëtimi i të ardhurave

Treguesi i arkëtimit të të ardhurave paraqet, përqindjen e mbledhur të shumave të faturuara për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit gjatë vitit. Ky është njëri prej treguesve me domethënës i cili krahas efijencës së faturimit dhe reduktimit të humbjeve të ujit, ka impakte të drejtpërdrejta në qëndrueshmërinë financiare të kompanisë.




Fig. 26. Efijenca në arkëtimin e të ardhurave/ faturimit (përfshijtur të ardhurat e tjera operative)

Siç vërehet edhe nga figura në vitin 2015, në shumicën e kompanive, kemi një përmirësim me të theksuar të efijencës së arkëtimit të borxheve për shërbimet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimit, përjashtuar KRU 'Prishtina', dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor' të cilat kanë treguar performancë me të dobët krahasuar me vitin 2014. Progresin më të lartë në shkallën e arkëtimit e ka arritur KRU 'Mitrovica' me një ngritje prej 8% krahasuar me vitin paraprak, rezultat i të cilës kryesisht ka qenë ndërmarrja e disa aktiviteteve nga kompania siç janë: aplikimi i shkyçjeve, fshirja e borxheve bazuar në Ligjin për faljen e borxheve publike, stimulimi dhe ndëshkimi i lexuesve, inkasantëve dhe shefave të njësive apo shërbimeve.

Shkalla e arkëtimit për faturat e shërbimit të ujit dhe të kanalizimit si mesatare e sektorit për vitin 2015, nuk ka ndryshuar nga viti paraprak që d.m.th, ka mbet e njëjtë në nivelin 74%.

Objektivat e përcaktuara me proceset rregullatore (tarifore) për vitin 2015 nuk kanë mundur të arrihen në shumicën e kompanive. Përderisa në nivel të sektorit, devijimi është vetëm prej 1% nga 75% e planifikuar. KRU "Radoniqi", në vitin 2015 ka arritur planifikimet madje ka tejkaluar cakun e planifikuar të shkallës së inkasimit për 7%, ndërsa KRU 'Hidromorava' dhe KRU 'Hidrodrini' kanë mbetur në nivel të njëjtë me 78% përkatësisht 73%.

Edhe pse, përmirësimi është gradual, efijenca në shkallën e arkëtimit nga konsumatorët shtëpiak mbetet ende sfidë gati për të gjitha KRU. Nën-performanca komerciale e përgjithshme e ulët dhe mos arritja e objektivave në arkëtimin e të ardhurave dhe shitjeve siç ishte planifikuar, ka bërë që para e pritshme e gatshme në disponim për investime, praktikisht të mungojë. Ky ka qenë edhe shkak kryesor i dështimit për të përmbushur, objektivat e investimeve të planifikuara nga mjetet vetanake të KRU.

Kthimi në Kapital

Kthimi në kapital siç dihet është fut në përdorim në procesin tarifor (2009-2011) dhe ka vazhduar në vitet deri me tani si kusht i domosdoshëm për të arritur një nivel huamarrës të mjaftueshëm për të tërhequr investimet shumë të nevojshme për sektorin.

Për rishikimin tarifor 2015-2017, ARRU ka propozuar një normë të vërtet të kthimit (pas inflacionit) prej 4% ne bazën rregullatore të aseteve (BRRRA)¹¹, pra një normë reale të kthimit në kapital e cila është e bazuar në praktikat e mira të vendeve të Evropës Perëndimore.




Fig. 27, Kthimi në bazën rregullatore të aseteve (BRRRA)

Kthimi në kapital në nivel të sektorit është pozitiv për vlerën 2% duke shënuar përmirësim në vitin 2015 në raport me vitin 2014 kur ai ishte negativ.

Katër nga shtatë KRU (Radoniqi, Prishtina, Bifurkacioni dhe Hidrodriini) kanë pasur kthime pozitive, madje dy prej tyre kanë tejkalluar nivelin e planifikuar prej 4%, e të cilat edhe kanë arritur ti mbajnë shpenzimet e tyre, përfshirë zhvlerësimin sipas kostos aktuale dhe mirëmbajtjen infrastrukturore në BRRRA, brenda kufijve të të ardhurave të tyre dhe duke u dhënë mundësinë për të bërë investime të reja.

Për dallim nga viti i kaluar KRU ‘Hidroregjioni Jugor’ dhe KRU ‘Hidromorava’, kishin përmirësim në normë, ndonëse kthimi ende është negativ. Përkundër kësaj KRU Mitrovica’ kishte kthimin në kapital akoma edhe më keq në normën prej (-11.1%) krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i shpenzimeve të larta operative duke mos arritur ti mbulojë nga të ardhurat e saj përkundër ngritjes së tyre krahasuar me vitin 2014.

¹¹ Per detaje te metejshme mbi bazen rregullatore te aseteve (se si eshte definuar dhe e percaktuar)referojuni Udhëzimeve Rregullatore të Kontabilitetit të ARRU

3.4 Performanca e përgjithshme e KRU

Struktura e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve konsiderohet të jetë ajo e një monopoli natyror, prandaj në mungesë të konkurrencës në treg, ARRU përmes rregullimit ekonomik angazhohet të caktojë parakushtet për mos shfrytëzim të përparësive të tilla të cilat i ka ky shërbim, duke përcaktuar kriteret e rregullimit të shërbimit me të cilat krijohen parakushtet për qëndrueshmëri financiare dhe vazhdimësi të shërbimeve nga kompanitë e licencuara nga/ prej saj dhe të përcaktojë tarifa të ekuilibruara të cilat janë të përballueshme për pagesë të faturave që konsumatorët i marrin për shërbimet e ofruara. Një metodë për ta bërë këtë të tillë është parimi i krahasimit, ku performanca e ofruesve të ndryshme mund të matet kundër njëri-tjetrit sipas standardeve të përcaktuara vendore. Globalisht konkurrenca krahasuese (Benchmarking) ka provuar të nxit konkurrencën midis operatoreve të shërbimeve publike të ujit, ngrit motivimin e tyre, për të përmirësuar performancën e tyre, si dhe të bëjë performancë më mirë se kompanitë tjera simotra.

Ne e kemi vlerësuar performancën e përgjithshme për çdo sektor (furnizimi me ujë dhe ujërat e zeza) mbi bazën e cilësisë, niveleve të shërbimit, mbulueshmërisë dhe efijencës së kostos. Këto pastaj janë kombinuar dhe i është shtuar efijenca komerciale dhe financiare (arkëtimi i të ardhurave dhe kthimi në BRRA) për të arritur në një matje të përgjithshme të performancës së KRU. Të gjitha matjet e performancës janë të shprehura si përqindje e ku idealja është 100%.

Vlerësimi i performancës së realizuar fokusohet në treguesit kyç, të specifikuar si me poshtë:

- (i) Shërbimet e furnizimit me ujë
 - Treguesit jo-financiar (teknik) kyç të performancës
 - Treguesit jo-financiar (komercial) kyç të performancës
 - Treguesit financiar kyç të performancës
- (ii) Shërbimet për ujëra të zeza
 - Treguesit jo-financiar (teknik) kyç të performancës
 - Treguesit jo-financiar (komercial) kyç të performancës
 - Treguesit financiar kyç të performancës
- (iii) Performanca financiare e KRU (ujë dhe ujëra të zeza)
 - Shitja dhe arkëtimi i të ardhurave
 - Vlerat kyçe financiare dhe normat

Kjo përzgjedhje e treguesve të performancës, pasqyron më së miri nivelet e shërbimit dhe efijencën e kostos edhe efijencën komerciale, e që të gjitha kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi konsumatorët. Për më tepër, performanca e vlerësuar në këtë raport, matet në mënyrë absolute edhe ndaj nivelit të një performace 'ideale' kundrejt krahasimit relativ.

3.4.1 Shërbimet e furnizimit me ujë

Kjo pjesë e raportit paraqet vlerësimin e performancës së përgjithshme të shtatë KRU në shërbimin e furnizimit me ujë dhe bazohet në vlerësimin krahasues në lidhje me nivelin 'ideal' të performancës së pritshme të kompanisë që funksionon mirë dhe ofron furnizim efijent me ujë. Gjithnjë duke dhënë edhe një pasqyrë të performancës krahasuese të vetë kompanive dhe në raport me njëra-tjetren.

Vlerësimi vjetor i performancës në shërbimet e furnizimit me ujë është bërë përmes 5 treguesve në vijim:

- Mbulueshmëri komplete (100%) me shërbim në zonën e shërbimit;
- Cilësia e ujit të furnizuar 100% në pajtueshmëri me standardet kombëtare të specifikuar;
- Presioni i ujit me nivelet e specifikuar minimale dhe maksimale;
- Uji për të gjithë konsumatorët në baza të vazhdueshme (24 orë në ditë, shtatë ditë në javë);
- Efijenca e kostos (kosto për njësi të ujit të shitur në raport me pritjet sipas planit të biznesit).




Fig. 28. Paraqet rezultatet në vlerësimin e performancës së furnizimit me ujë, si dhe rangimin e KRU(2014 & 2015)

Në vitin 2015 niveli mesatar i performancës së përgjithshme është 36.9%, në raport me performancën absolute (ideale) dhe është me e përmirësuar për 1.2%. Performanca e përgjithshme e furnizimit me ujë, ende mbetet (për 8.1%) më e ulët se performanca ideale e synuar prej 45%, të ndarë për këtë shërbim.

KRU ‘Radoniqi’, ka performancën më të mirë në furnizim me ujë në vitin 2015, ndonëse nuk ka shënuar përmirësim në vlerësimin total. Përndryshe, përmirësimet janë evidente tek të gjithë treguesit e furnizimit me ujë, në përjashtim të efijencës së kostove. Në përgjithësi kjo kompani ka treguar performancë pranë ideale në shumicën e treguesve.

Kompania me përmirësimin më të madh në furnizimin me ujë në vitin 2015 në raport me vitin 2014, është KRU ‘Prishtina’, performanca e së cilës është për 2.9% më e përmirësuar, ndonëse e ranguar si e para fundit, është vazhdimësia e furnizimit me ujë ajo e cila lënë hapësirë shumë për përmirësim në këtë kompani.

Tabela 5. Rezultatet për performancën e përgjithshme të furnizimit me ujë në vitin 2014

KRU	Cilësia e Ujit	Presioni	V. Furnizimit	Mbulueshmëria	Efic.e kostove	Totali
GJA	29.7%	4.9%	34.4%	19.3%	4.0%	41.6%
PE	29.2%	5.0%	34.9%	18.2%	2.3%	40.3%
PZ	27.3%	5.0%	34.6%	13.1%	3.6%	37.6%
FE	29.8%	5.0%	23.0%	17.3%	0.00%	33.8%
MIT	29.6%	5.0%	24.3%	12.6%	7.6%	35.6%
GJI	29.8%	4.8%	20.4%	13.4%	0.00%	30.8%
PR	29.8%	5.0%	10.8%	20.2%	1.3%	30.2%
Ideal	30%	5%	35%	20%	10%	45.0%
Sektori/Realizimi	29.3%	5.0%	26.0%	16.3%	2.7%	35.7%

Tabela 6, Rezultatet për performancën e përgjithshme të furnizimit me ujë në vitin 2015

KRU	Cilësia e Ujit	Presioni	V Furnizimit	Mbulueshmëria	Efic.e kostove	Totali	Ndryshimi 2014/2015
GJA	30.0%	5.0%	35.0%	20.0%	2.7%	41.5%	0.0%
PE	27.7%	5.0%	35.0%	19.1%	3.4%	40.6%	0.2%
PZ	28.4%	5.0%	34.7%	13.4%	5.0%	38.9%	1.3%
MIT	29.4%	4.7%	32.2%	13.1%	4.4%	37.7%	2.1%
GJI	30.0%	4.8%	20.5%	13.5%	5.6%	33.4%	2.7%
PR	30.0%	5.0%	13.1%	21.2%	4.3%	33.1%	2.9%
FE	29.9%	4.5%	19.6%	17.6%	1.7%	32.9%	-0.9%
Ideal	30.0%	5.0%	35.0%	20.0%	10.0%	45.0%	
Sektori	29.3%	4.9%	27.1%	16.8%	3.9%	36.9%	
Ndryshimi 2014/2015	0.0%	-0.1%	+1.1%	+0.5%	+1.2%	+1.2%	-8.1%

Përmirësimi ka ndodhur në vitin 2015 në tre treguesit e rëndësishëm: vazhdimësia e furnizimit, mbulueshmëria me shërbime dhe po ashtu, treguesi i efikasitetit të kostove e cila është për 1.2% më e përmirësuar në raport me vitin paraprak 2014.

Treguesit e standardeve të shërbimit kryesisht janë të qëndrueshëm, ndonëse ende ka mjaft hapësirë për përmirësime:

Kualiteti i ujit është në nivel të kënaqshëm, shtatë kompanitë rajonale të ujësjes kanë arritur në nivel të përgjithshëm prej 97.0% të përputhshmërisë me standardet vendore të cilësisë së ujit të pijshëm në Kosovë.

Presioni i ujit në vitin 2015 ka pasur trende negative në mesatare 2015, janë raportuar për 1/3 më shumë se sa ishin në vitin 2014, kjo është edhe për faktin se këtë vit edhe KRU 'Mitrovica' dhe 'Bifurkacioni', kanë raportuar të kenë probleme me presion të ulët për një numër pronash, përgjatë zonës së tyre të shërbimit.

Vazhdimësia e furnizimit është përmirësuar për 1.1%, është KRU 'Mitrovica', ajo e cila ka përmirësuar dukshëm vazhdimësinë e furnizimit, përderisa edhe,

Mbulueshmëria me shërbime, në mesatare të sektorit ka shënuar rritje të lehtë prej 0.5% në vitin 2015 në raport me vitin 2014.

3.4.2 Shërbimet për ujëra të zeza

Vlerësimi i performancës së përgjithshme të shtatë KRU në shërbimin me ujëra të zeza, bazohet po ashtu në vlerësimin krahasues në lidhje me nivelin 'ideal' të performancës së pritshme të kompanisë që funksionon mirë dhe ofron shërbime eficientë të ujërave të zeza.

Vlerësimi vjetor i performancës në shërbimet për ujëra të zeza, bëhet përmes 4 treguesve vijues:

- Mbulueshmëri pothuajse e kompletuar (deri 95%) me sistemin e kanalizimit për ujëra të zeza në zonat e shërbimit¹²
- Cilësi e ujërave të zeza të shkarkuara në shkallën prej 100% të pajtueshmërisë me standardet e specifikuar mjedisore;
- Besueshmëri e shërbimeve për ujëra të zeza me zero shtëpi të prekura nga vërshimet e kanalizimeve;
- Eficienta e kostos (kostot për njësi e shërbimeve për ujëra të zeza duke përfshirë ekuivalentet e amvisërisë).

¹² Mbulimi i plotë i shërbimit për shërbimet e ujërave të zeza nuk është ideal pasi që në zonën e shërbimit mund të ketë një pjesë të vogël të amvisërive ku kyçja në sistemin e kanalizimit është e pamundur. Për qëllime të raportimit të performancës një vlerë prej 95% e mbulueshmërisë me shërbime për ujëra të zeza konsiderohet si një pritje ideale




Figura 29, Performanca e përgjithshme e shërbimeve të ujërave të zeza (2014 & 2015)

Figura 29, tregon performancën e përgjithshme të KRU në lidhje me shërbimet e ujërave të zeza. Meqenëse nuk kemi impiante për trajtimin e ujërave të zeza në Kosovë, ne ende nuk mund të bëjmë vlerësimin e performancës në treguesin e cilësisë së shkarkimit të ujërave të zeza. Në mënyrë të njëjtë nuk kemi mundur të bëjmë vlerësimin e performancës në treguesin e besueshmërisë për të gjitha KRU (e matur mbi bazën e vërshimeve / bllokimeve për 100 km gyp në vit) meqenëse ajo është më e lartë se maksimalja absolute prej 100, dhe të gjitha KRU do të marrin zero pikë për këtë parametër.

Diagrami i performancës i treguar në fig 29, ilustron nevojën për investime të konsiderueshme në përmirësimin e infrastrukturës së ujërave të zeza, duke përfshirë: zhvillimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza, si dhe objekteve përcjellëse.

Tabela 7, Rezultatet për performancën e përgjithshme në shërbimin e ujërave të zeza në vitin 2014

KRU	Cilësia e shkar.	Besueshmëria	Mbulueshmëria	Efic. e kost.	Totali
FE	0.0%	0.0%	42.3%	4.0%	16.19%
PR	0.0%	0.0%	41.6%	4.7%	16.18%
PZ	0.0%	0.0%	28.1%	8.5%	12.82%
GJA	0.0%	0.0%	25.8%	4.3%	10.51%
GJI	0.0%	0.0%	24.7%	5.2%	10.46%
MIT	0.0%	0.0%	25.0%	4.0%	10.15%
PE	0.0%	0.0%	18.7%	4.4%	8.10%
Ideal	20.0%	20.0%	50.0%	10.0%	35.00%
Sektori/Realizim	0.0%	0.0%	29.5%	5.0%	12.1%

Tabela 8, Rezultatet për performancën e përgjithshme në shërbimin e ujërave të zeza në vitin 2015

KRU	Cilësia e shkar.	Besueshmëria	Mbulueshmëria	Efic. e kost.	Totali	Ndryshimi 2014/2015
PR	0.0%	0.0%	44.7%	3.4%	16.8%	0.6%
FE	0.0%	0.0%	39.8%	4.7%	15.6%	-0.6%
GJA	0.0%	0.0%	30.7%	7.9%	13.5%	3.0%
PZ	0.0%	0.0%	28.9%	5.0%	11.9%	-1.0%
GJI	0.0%	0.0%	25.7%	6.3%	11.2%	0.7%
MIT	0.0%	0.0%	25.7%	2.3%	9.8%	-0.3%
PE	0.0%	0.0%	19.1%	5.3%	8.5%	0.4%
Ideal	20.0%	20.0%	50.0%	10.0%	35.0%	
Spektori	0.0%	0.0%	30.6%	5.0%	12.5%	
Ndryshimi 2014/2015	0.0%	0.0%	1.2%	0.0%	0.4%	-22.5%

Në nivel të përgjithshëm në vitin 2015, përmirësimi është për 0.4% në krahasim me një vit më parë, totali i pikëve është 12.5%, kjo është për 22.5% më e ulët se sa niveli ideal i synuar në këtë shërbim prej 35%.

Performanca e shërbimit të ujërave të zeza në vitin 2015 ka shënuar përmirësime të lehta në raport me vitin 2014. Kryesisht përmirësimi ndërlidhet me zgjerimin e mbulueshmërisë me shërbime, e cila në përgjithësi në nivel të sektorit është përmirësuar për 1.2%. Efiçenca e kostove në shërbimin e ujërave të zeza ka mbetur në nivel të njëjtë gjatë kësaj periudhë vlerësuese(2014-2015).

KRU 'Prishtina', ka performancën më të mirë në këtë shërbim në raport me kompanitë e tjera, me tendence të përmirësimit gradual. Përderisa kompania e cila ka performancën më të dobët vazhdon të jetë KRU 'Hidrodrini'.

3.4.3 Përfomanca e përgjithshme e KRU

Përfomanca e përgjithshme e KRU bashkon performancën e dy sektorëve të biznesit: furnizimit me ujë dhe ujërave të zeza e po ashtu edhe të aspekteve më të gjëra komerciale: Profitabilitetit dhe performancës në arkëtimin e të ardhurave.

- Performanca e përgjithshme në furnizim me ujë(deri në 100%)
- Performanca e përgjithshme e shërbimit të ujërave të zeza (deri në 100%)
- Përfitueshmëria (kthimi në kapital që tejkalon pritjet sipas biznes planit);
- Aktivitete efiçente komerciale (arkëtim 100% i të ardhurave).

Performanca e përgjithshme e KRU




Figura 30, Performanca e përgjithshme e KRU (2014 & 2015)

Shihet qartë se, pa asnjë përjashtim, KRU janë duke operuar në nivele edhe më të ulëta se çfarë do të konsiderohej një nivel minimal, p.sh. le të themi, 80% e ideale. Dihet se arsyeja kryesore që ndikon në performancën e përgjithshme janë shërbimet e ujërave të zeza, dhe mungesa e trajtimit.

Në figurën 30, është pasqyruar, rangimi i KRU sipas performancës se tyre për vitet 2014-2015, dhe në raport me kompaninë Ideale.

Në përgjithësi, performancën më të mirë në vitin 2015 e ka KRU 'Radoniqi', duke arritur nivelin prej 70.9% nga maksimalja prej 100%, të cilin nivel e kanë ofruesit me performancën e përvetësuar ideale, performanca e KRU 'Radoniqi', është po ashtu më e përmirësuar dhe atë për 14.3%, nga viti i kaluar.

Në vitin 2015 performanca e të gjitha KRU, ka qenë më e përmirësuar se sa në vitin 2014. Përmirësimin më të lartë e kanë shënuar KRU 'Radoniqi' dhe KRU 'Prishtina', por edhe Bifurkacioni, përdërisa me pak përmirësim ka shënuar KRU 'Hidroregjioni Jugor'.

Tabela 9, Rezultatet për performancën e përgjithshme të KRU në vitin 2014

KRU	Furnizimi me Ujë	Ujëra të Zeza	Profitabiliteti	Arkëtimi	Totali i pikëve
Ideale	45%	35%	10%	10%	100%
GJA	39.9%	10.5%	0.5%	5.7%	56.6%
PE	39.4%	8.1%	3.9%	1.9%	53.3%
PZ	36.1%	12.8%	0.0%	3.9%	52.8%
FE	33.8%	16.2%	0.0%	0.9%	50.9%
PR	29.7%	16.2%	0.0%	4.9%	50.8%
GJI	30.8%	10.5%	0.0%	3.1%	44.3%
MIT	32.5%	10.1%	0.0%	0.0%	42.7%
Sektori	34.6%	12.1%	0.6%	2.9%	50.2%

Tabela 10, Rezultatet për performancën e përgjithshme të KRU në vitin 2015

KRU	Furnizimi me Ujë	Ujëra të Zeza	Profitabiliteti	Arkëtimi	Totali i pikëve	Ndryshimi 2015/2014
Ideale	45%	35%	10%	10%	100%	
GJA	41.5%	13.5%	10.0%	5.9%	70.9%	14.3%
PR	33.1%	16.8%	10.0%	3.9%	63.8%	13.1%
PE	40.6%	8.5%	6.3%	3.2%	58.6%	5.3%
FE	32.9%	15.6%	7.6%	1.4%	57.6%	6.6%
PZ	38.9%	11.9%	0.0%	3.6%	54.3%	1.5%
GJI	33.4%	11.2%	0.0%	4.6%	49.2%	4.9%
MIT	37.7%	9.8%	0.0%	0.0%	47.5%	4.8%
Sektori	36.88%	12.48%	4.85%	3.21%	57.42%	
Ndryshimi 2015/2014	+2.3%	+0.4%	+4.2%	+0.3%	+7.2%	-42.58%

Performanca e përgjithshme e KRU, në vitin 2015 ka arritur nivelin 57.42%, në raport me performancën e synuar ideale dhe është më e përmirësuar për 7.2% në raport me vitin 2014. Përmirësimi është evident në të dyja shërbimet: furnizimi me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza, përmirësim po ashtu është shënuar edhe tek profitabiliteti, si dhe eficientia e arkëtimit.

Furnizimi me ujë ka arritur në shkallën 36.88% nga maksimalja prej 45%, përmirësimi është për 2.3%, në raport me një vit më parë.

Shërbimi i ujërave të zeza është dukshëm më i ulët se ajo e furnizimit me ujë. Në vitin 2015, është arritur niveli 12.48%, nga maksimalja e mundshme prej 35%, duke shënuar shumë pak përmirësime vetëm për 0.4%.

Profitabiliteti paraqet kthimin aktual në bazën rregullatore të aseteve në raport me kthimin në kapital të projektuar, përmes procesit tarifor (2015-2017). Në këtë drejtim KRU kanë pasur një përmirësim evident edhe pse kjo është më e ulët se ajo që është planifikuar, prej 4.0%. Shkalla e profitabilitetit në mesatare të sektorit ka qenë në nivelin prej 4.85%, në 2015 nga maksimalja prej 10% dhe në krahasim më vitin 2014, është më e përmirësuar për 4.2%. Përderisa në vitin 2015, vetëm tri KRU (Hidroregjioni jugor, Hidromorava dhe Mitrovica), nuk kanë qenë profitabile.

Eficientia e arkëtimit është një fushë e cila lënë shumë për tu përmirësuar edhe pse vit pas viti është duke shënuar përmirësim, por që është shumë i ngadalshëm. Progresi po tregohet të jetë shumë i vështirë, sidomos mbetet sfida përmirësimi i arkëtimit të konsumatorët e amvisërisë dhe të bizneseve. Në këtë vit po ashtu është shënuar përmirësim modest me vetëm 0.3%, në raport me vitin paraprak, në këtë tregues në mesatare të sektorit është arritur niveli prej 3.21% nga maksimalja prej 10%. KRU 'Mitrovica', ka performancën me të dobët në eficientinë e arkëtimit, e cila nuk ka mundur të tejkaloj cakun me të ulët prej 60%, duke mos e siguruar asnjë pikë në këtë tregues.

PJESA B

PERFORMANCA E SEKTORIT TË SHËRBIMEVE TË UJËSJELLËSIT-KANALIZIMIT

4. PERFORMANCA E SEKTORIT

Pjesë e rëndësishme e raportit të performancës është performanca e sektorit si një tërësi, përmes vlerësimit të disa makro treguesve të performancës të tillë si: prodhimi i ujit, shitjet, UPF, mbuleshmëria me shërbime, qarkullimi në nivel të sektorit, si dhe investimet në total në dy shërbimet (furnizim me ujë dhe në shërbime të ujërave të zeza).

Për të pasur një pasqyrë sa më të qartë të trendëve të zhvillimit të treguesve të caktuar, kjo pjesë e raportit përmban një vlerësim të performancës së përgjithshme të sektorit për periudhën katër vjeçare (2012-2015).

4.1 Uji i prodhuar, shitjet dhe UPF

Fig. 31, pasqyron vëllimin e ujit të trajtuar dhe të shpërndarë në rrjetë, përndryshe në këtë figurë shifrat e humbjeve të ujit mund të shikohen në raport me shifrat prodhimit të ujit.




Figura 31, Vlerat sasiore të prodhimit të ujit, shitjeve dhe UPF-së

Pas dy viteve (2013-2014) të reduktimit të prodhimit të ujit, kryesisht për shkak të thatësisë e cila ka mbretëruar në vend, tani në vitin 2015 pothuajse sasia e ujit të prodhuar ka arritur atë të nivelit të vitit 2012. Në raport me vitin 2014, Uji i prodhuar në vitin 2015 ka qenë për 5.2 mil. m³ më e lartë.

Kjo rritje e prodhimit ka ndodhur kryesisht tek KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina', por edhe kompanitë e tjera kanë shënuar rritje të prodhimit të ujit përjashtuar nga ky rast KRU 'Hidrodrini' tek e cila ka rënë prodhimi i ujit për rreth 4.2 mil. m³ në vitin 2015. Kjo rritje e prodhimit tek shumica e KRU, ka qenë e nevojshme për të përmirësuar orët e furnizimit në zonën e shërbimit, si dhe për të shërbyer zgjerimit të bazës së konsumatorëve.

KRU duhet të synojnë reduktimin e UPF, para se të vendosin për rritjen e prodhimit. Me efikasitet të mirë operativ, një rritje e prodhimit të ujit duhet të jetë e nevojshme vetëm me një rritje të bazës së konsumatorëve dhe /ose për të përmirësuar orët e furnizimit.

Uji i pa faturuar i humbur: përmes rrjedhjeve, lidhjeve të paligjshme, pajisjeve matëse me të meta ose konsumimit të paregjistruar, vazhdon të jetë një shqetësim për sektorin. Në vitin 2015 rreth 77.3 mil. m³, është uji i pa faturuar duke shënuar humbjen e të ardhurave dhe rritje të shpenzimeve operative.

Gjatë tri viteve të para të kësaj periudhe vlerësuese, shitjet sasiore të ujit nuk kanë shënuar përmirësim, përkundrazi kanë pasur një trend të përkeqësimit. Është e evidente se në vitin 2015 është shënuar përmirësim. Nga totali i prodhimit prej 137 mil. m³, rreth 59.8 mil. m³, janë faturuar (shitur). Kjo është për rreth 4.0 mil. m³ uji i shitur me tepër nga të gjitha KRU gjatë vitit 2015, në krahasim me shitjet e ujit të regjistruar gjatë vitit 2014.

4.2 Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit

Paraqet raportin e popullsisë vendore me qasje të sigurt dhe të besueshëm në shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit të ofruar nga KRU-të.




Figura 32, Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit

Në fig.32, janë dhënë trendet e progresit të mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit, përgjatë katër viteve të fundit (2012-2015).

Treguesi i mbulimit të ujësjellësit është rrit nga 78% në vitin 2012 në 87% në vitin 2015, që d.m.th. një normë rritje prej 9%, gjatë kësaj periudhe 4 vjeçare.

Treguesi i mbulueshmërisë me shërbime të kanalizimit po ashtu ka shënuar trende graduale të përmirësimit vit pas viti. Përderisa në vitin 2012, niveli i mbulueshmërisë me kanalizim ishte 56%, në vitin 2015 ka arritur në nivelin 65%, po ashtu i rritur për 9% për periudhën (2012-2015).

Ky tregues mbetet ende nën nivelin e pranueshëm, prandaj, ka nevojë për më shumë fokus në kanalizim për të reduktuar pasojat e tij të pafavorshme. Niveli i ulët i shërbimit të kanalizimit përbën një sfidë serioze për shëndetin publik dhe në mënyrë të konsiderueshme i kontribuon përkeqësimit të cilësisë së burimeve ujore.

4.3 Të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe paraja e gatshme e arkëtuar

Me qarkullim në këtë rast nënkupton të hyrat nga faturimi i rregullt dhe të hyrat tjera operative për shërbime të ujit dhe ujërave të zeza.

Në figurën 33, është pasqyruar efikasiteti mesatar i qarkullimit dhe inkasimit, gjatë 4 viteve të fundit (2012-2015).




Figura 33. Shumat monetare për faturimin dhe arkëtimin aktual

Edhe pse ARRU gjatë procesit tarifor (2015-2017) ka qenë më i kujdesshëm se sa që ishte në proceset e kaluara gjatë përcaktimit të objektivave, të cilat do të jenë realisht të arritshme por njëkohësisht edhe sfiduese. Ne me keqardhje konstatojmë se objektivat e planifikuara e sidomos ato në lidhje me faturimin, arkëtimin, nuk kanë mundur të arrihen akoma por që të paktën vazhdojnë të jenë paralel krahasuar me vitet paraprake ku kishte shumë distanca mes tyre.

Efiçenca e Qarkullimit¹³ në vlerë monetare në nivel sektori gjatë vitit 2015, ka shënuar përmirësim për 2.5 milion€ apo shprehur në përqindje për 9% në raport me vitin 2014, ky përmirësim i lehtë i atribuohet zgjerimit të bazës së konsumatorëve, vit pas viti e më pas edhe ngritjes së efikasitetit të të ardhurave nga faturimi.

Efiçenca e arkëtimin¹⁴, në vitin 2015 po ashtu ka shënuar përmirësim në vlerë monetare për 1.8 milion€, apo shprehur në përqindje për 8% në krahasim me vitin 2014.

Efiçenca e arkëtimin në raport me efiçencën e qarkullimit në nivel të sektorit në vitin 2015 ishte 75%, dhe më e lartë për 4% krahasuar me vitin 2012, të cilat vlera mund ti gjeni edhe në tabelën e më poshtme.

Tabela 11. Qarkullimi dhe arkëtimi sipas viteve

Vitet	Qarkullimi	Arkëtimi/keshi	Keshi/Qarkullimin
2012	29,111,469.23	20,609,696.24	71%
2013	29,715,954.43	21,225,741.79	71%
2014	29,296,792.70	21,890,722.67	75%
2015	31,657,595.66	23,620,483.78	75%

¹³ Qarkullimi ka përfshirë të hyrat nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujit dhe të ujerave të zeza si dhe të hyrat nga aktivitetet operative duke përfshirë të hyrat financiare/jo operative.

¹⁴ Keshi (Efiçenca e arkëtimin) ka përfshirë arkëtimin nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujit dhe të ujerave të zeza si dhe të hyrat nga aktivitetet e tjera operative.

4.4 Investimet kapitale për shërbime të furnizimit me ujë dhe ujëra të zeza

Një faktor tjetër shumë i rëndësishëm në sektor, janë investimet kapitale. Ato janë shpenzime për asetet që janë ndërtuar për të ofruar shërbime të furnizimit me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza për konsumatorët. Në këtë seksion, kemi paraqitur pra, analizën e shpenzimeve kapitale të shtatë KRU, reale dhe ato të planifikuara përgjatë procesit tarifor (2012-2014) dhe procesit tarifor (2015-2017) përkatësisht për vitin 2015. Nga të gjitha KRU është pritur që të realizojnë investime të konsiderueshme në shërbimin e furnizimit me ujë dhe në shërbimin e ujërave të zeza dhe nga totali i shumës së planifikuar për periudhën trevjeçare tarifore (2012-2014), prej afro 95 milion € dhe periudhës një vjeçare për vitin 2015 afër 46.5 milion €, me një ndarje prej përafërsisht me 2/3 në furnizim me ujë dhe 1/3 në shërbimin e ujërave të zeza. Nga mjetet vetanake të KRU, po ashtu është planifikuar të investohen rreth 25 milion € për vitet 2012-2014 dhe 5.8 milion € për vitin 2015, shpenzime kapitale në të dy shërbimet (furnizim me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza), pjesa tjetër nga donatorët.

Tabela 12. Investimet kapitale 2012-2015

Kompania	2012	2013	2014	2015
KRU"Prishtina"	5,079,692.45	9,027,944.72	1,592,704.13	961,127.00
KRU"Hidroregjioni Jugor"	3,388,492.59	1,552,776.75	909,195.35	1,151,166.31
KRU"Hidrodrini"	4,742,892.56	901,564.07	802,008.43	2,028,852.00
KRU"Mitrovica"	21,850.82	2,060,992.78	0.00	0.00
KRU"Radoniqi"	397,359.49	1,348,647.11	1,166,757.54	1,306,505.82
KRU"Bifurkacioni"	702,391.82	58,461.05	3,060,203.32	278,347.00
KRU"Hidromorava"	1,367,079.59	32,350.48	1,971,970.76	204,227.69
Totali	15,699,759.32	14,982,736.97	9,502,839.53	5,930,225.82

Vlera e investimeve, përgjatë këtyre katër viteve, ka qenë 46.1 mil.€, mjete të investuara, kryesisht nga donatorët, si dhe një pjesë më e vogël nga KRU. Në raport me vlerën e planifikuar realizimi i investimeve arriti nivelin prej 33%.

Nga shuma e përgjithshme rreth 16.6 mil.€ janë realizuar në KRU 'Prishtina', përderisa më pakë shpenzime kapitale, janë realizuar në KRU 'Mitrovica', në këto tri vite (2. mil.€). Nga mjetet vetanake KRU kanë shpenzuar për investime kapitale në vlerën prej 7.8 mil.€, që në raport me provizionimin e planifikuar, përmes BPRR prej 30.8 mil.€ paraqet normën 23%.

Edhe pse ka pasur fonde të kanalizuar në drejtim të investimeve në këtë sektor, ka ende nevojë të bëhet shumë më tepër, duke pasur parasysh kërkesat e mëdha për investime. Sektori i ujit dhe ujërave të zeza ka nevojë për mbështetje të mëtejme investuese dhe përpjekje të bashkërenduara nga akterë të ndryshëm.

PJESA C

PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT ME SHUMICË (NPH IBËR-LEPENC)

5. PERFORMANCA E NHE 'Ibër Lepenci'

ARRU është përgjegjës për rregullimin e pjesës së afarizmit të NHE 'Ibër Lepenci' sh. a. Prishtinë, e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina' gjegjësisht për Nj. O 'Drenas'.

Në vazhdim po i japim disa të dhëna statistikore dhe disa tregues të performancës për të parë trendët e zhvillimit të performancës në vitin 2015 në raport me vitin 2014

Tabela 13, Të dhënat statistikore për NHE 'Ibër-Lepenci' sh. a. Prishtinë

Të dhënat statistikore për 2015 / 2014	2014	2015
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m3)	19,288,948	23,589,360
Faturimi për ujin me shumicë (€)	547,657	489,595
Arkëtimi për ujin me shumicë (€)	817,770	93,268
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	466,258	450,698
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	33	33

Në tabelën 14, është dhënë një pasqyrë të treguesve financiar në bazë të cilëve mund të vlerësohet performanca e NHE 'Ibër Lepenci' gjatë vitit 2015 krahasuar me vitin 2014.

Tabela 14, Treguesit e Performancës se NHE 'Ibër-Lepenci'

Treguesi i performancës	2014	2015
Shkalla e arkëtimit	149%	19%
Norma e punës	1.17	1.09
Norma e mbulimit të punës	1.75	0.21
Kostoja e operimit për njësi (€/m3)	0.02	0.02

Shkalla e arkëtimit në vitin 2015 ka rënë në nivelin më të ulët si asnjëherë më parë dhe atë nga 149% në 19%, dhe kjo ka ndodhur si rezultat i mos arkëtimit të borxhit nga KRU 'Mitrovica'.

Përkundër rënies së kostos së operimit për furnizimin e ujit me shumicë, kostoja për njësi ka mbetur njëjtë në nivelin 0.02 euro/m3, si rezultat i rritjes së vëllimit me shumicë të ujit të faturuar prej 22%,

PJESA D

AKTIVITETET E KKK

6. AKTIVITETET E KKK

Një nga synimet kryesore të ARRU është mbrojtja e interesave të konsumatorëve, duke u përkujdesur që shërbimet e ofruara nga kompanitë e licencuara të jenë në nivelin e standardeve të përcaktuara dhe se konsumatorët kanë në dispozicion mekanizma efektiv për adresimin e ankesave dhe pakënaqësive të tyre. Me qëllim të realizimit të drejtave dhe të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ARRU ka themeluar shtatë Komisione Këshillues të Konsumatorëve për shërbimet e ujit në 7 regjione të Kosovës sipas planit për konsolidimin të ofruesve të shërbimeve të ujit. Opinioni i tyre është i një rëndësie të madhe për rregullatorin sepse japin një pasqyrë reale në matjen e cilësisë në ofrimin e shërbimit. Në përgjithësi ato luajnë një rol të rëndësishëm në:

- Zgjidhjen e ankesave të parashtruara nga konsumatorët të cilat nuk janë trajtuar dhe zgjidhur nga kompanitë në mënyrë të drejtë për konsumatorin,
- Ndërmarrjen e sondazheve, studimeve dhe anketimeve lidhur me standardet e shërbimeve me kërkesë të rregullatorit,
- Ofrimin e këshillave për rregullatorin lidhur me tarifat e shërbimeve, standardet e shërbimeve dhe aktivitete të tjera rregullatore.

Aktivitetet e KKK për vitin 2015 konsistojnë në: mbajtjen e takimeve (gjithsejtë 78 takime në të gjitha rajonet për çdo muaj), në të cilat janë shqyrtuar çështje të rëndësishme për konsumatorin përfshirë shqyrtimin e: ankesave të konsumatorëve, procedurave, lidhur me trajtimin e ankesave të konsumatorëve, raportet lidhur me hulumtimin e opinionit të konsumatorëve për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit në Kosovë, tarifat e vendosura për ujë dhe kanalizim për vitet në vijim, akteve nënligjore të ARRU, si dhe çështjeve të tjera të cilat janë në interes të konsumatorëve.

Në shtator të vitit 2015, është bërë emërimi i kryesuesve të KKK në gjashtë rajonet e Kosovës; Mitrovicë, Prizren, Ferizaj, Gjiilan, Pejë dhe Gjakovë. Po ashtu ka vazhduar bashkëpunimi me institucionet relevante sidomos me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë gjegjësisht me departamentin për mbrojtjen e konsumatorit.

Tabela 15, Numri i ankesave të parashtruara në KKK

REGJIONI	2014		2015	
	Ankesa të parashtruara	Ankesa të zgjidhura	Ankesa të parashtruara	Ankesa të zgjidhura
KKK -Prishtinë	130	111	205	163
KKK -Mitrovicë	0	0	2	
KKK- Pejë	0	0		
KKK -Gjakovë	18	22	11	5
KKK- Prizren	11	8	6	6
KKK -Ferizaj	13	10	18	7
KKK -Gjiilan	5	5	24	20
Gjithsejtë	177	156	266	201

Gjithsejtë janë adresuar në të gjitha KKK, 266 ankesa prej tyre, janë zgjidhur 201. Numri total i ankesave të pranuar nga KKK në vitin 2015, është rritur ndjeshëm (për 65%), në raport me vitin 2014. Një pjesë e shkakut të rritjes se tyre mund të atribuohet gjatë zbatueshmërisë nga ana e KRU, të vendimit të marr nga qeveria e Kosovës për faljen e borxhit të konsumatorëve.

Konsumatorët më tepër janë ankuar në aspektet financiare si janë: kontestim i borxhit (139), zbritja, shlyerja e borxhit (49), faturimi paushall(22), faturim i lartë (50), kurse për shkaqe tjera përfshirë edhe aspektet operative dhe të standardeve të shërbimit janë ankuar shumë me pakë(6). Nga 266 ankesa mbi 2/3, prej tyre janë adresuar në KKK të regjionit të Prishtinës, përderisa më shumë janë ankuar konsumatorët e amvisërisë(254).

7. SFIDAT PËR TË ARDHMËN

EFIÇENCA E ARKËTIMIT e të ardhurave nga KRU, ende është shumë më i ultë sesa që duhet të jetë dhe konsiderohet të jetë sfida më serioze me të cilën përballlet sektori, ajo si e tillë është pengesë e madhe për të arritur nivelet e dëshiruara të shërbimit.

Në përgjithësi, KRU janë duke përmirësuar performancën e tyre vit pas viti, megjithëse me përmirësim gradual. Performanca e tanishme e arkëtimit të të ardhurave është në nivelin 74% të shumës së faturimit dhe ende është në një nivel më të ulët se sa që do të ishte e mjaftueshme për qëndrueshmëri afatgjatë të kompanive.

KRU duhet që të përmirësojnë performancën e tyre në arkëtim deri në nivelin ku ato do të arrijnë një nivel të arkëtimit më të madh se 90%. ku arkëtimi do të matej kundrejt faturimit të plotë, minus rastet sociale që nuk paguajnë. Një pjesë e konsumatorëve zgjedhin që mos ti paguajnë faturat e tyre (përfshirë rastet sociale e që llogaritet sipas vlerësimeve, mund të jenë afro 10%) thjesht për faktin se ata ja dalin mban me këtë, dhe personeli i KRU, ka pak nxitje për tu marrë me arkëtimin e faturave.

Çështja e përmirësimit të performancës së arkëtimit të të ardhurave në vazhdimësi, është adresuar nga institucionet vendore dhe projektet e ndryshme të mbështetur nga donatorët, duke kërkuar nga KRU që ato të jenë me pro aktive në këtë drejtim, për ti marrë të gjitha masat e duhura të cilat do të rezultojnë me një përmirësim të ndjeshëm.

Në përgjithësi janë të identifikueshme disa probleme madhore që kanë implikime domethënëse në përmirësimin e efiçencës së arkëtimit dhe të cilat mund të ndahen në:

Problemet e jashtme, të cilat KRU mund t'i adresojnë vetëm në mënyrë të tërthortë dhe në një afat më të gjatë siç janë:

- mos efiçencën e sistemit ligjor në Kosovë, mos prioriteti i dhënë kompanive të ujit në kërkimin e borxheve të tyre që rezultojn nga mospagesa e faturave të ujit.
- mos adresimi i rasteve sociale, përmes pagesës nga qeveria për mbulimin e faturave të ujit të konsumatorëve të klasifikuar si raste sociale. Kjo është e paraparë, edhe me ligjin bazik të ARRU, neni 20, pika 3.5 që parashe se është përgjegjësi e institucioneve qeveritare, jo e ofruesve të shërbimeve, për t'iu ndihmuar konsumatorëve me të ardhura të ulëta që t'i paguajnë faturat e tyre,

Nuk ekziston një veprim direkt afatshkurtër për KRU në mënyrë individuale e që do të mund të përdorin për të arritur rezultate në këtë fushë. Mënyra e vetme e mundshme që kjo të mund të zgjidhet është që KRU të veprojnë në bazë institucionale për shërbimet e ujit dhe të llojnë në qeveri për të ndryshuar situatën. SHUKOS është organ i duhur që do t'i qasej qeverisë në mënyrë që këto dy çështje të zgjidhen.

Problemet e brendshme që duhet të adresohen në një afat të shkurtër dhe drejtpërdrejtë nga KRU janë:

- krijimi i planit të përgjithshëm dhe zhvillimi i planeve specifike të veprimit për përmirësimin e efiçencës në arkëtimin e të ardhurave,
- përmirësimi i marrëdhënieve me konsumatorë & imazhi i kompanisë, është një aspekt që në të kaluarën nuk i është dhënë shumë vëmendje nga ana e kompanive të ujit, por këta janë faktorë shumë të rëndësishëm në garën për paratë e konsumatorëve,
- zhvillimi i mëtejshëm i politikave dhe procedurave, si një pjesë e rëndësishme e strukturës së menaxhimit të një KRU. Është e rëndësishme që ato jo vetëm që duhet të ekzistojnë, por të njëjtat të përditësohen dhe t'i përshtaten mjedisit vazhdimisht të ndryshueshëm në të cilat KRU operojnë,
- përdorimi i stimuljeve, për të ndihmuar përmirësimin e efiçencës së arkëtimit, duke zbatuar një skemë universale nxitjeje/stimuluese e që mund të financohet nga arkëtimi shtesë mbi nivelin e nevojshëm për të përmbushur të gjitha nevojat financiare të buxhetuara nga KRU.

UPF/ HUMBËTJA E UJIT, në Kosovë paraqesin një fenomen shumë të njohur. UPF është tepër i madh dhe raportohet se arrijnë në nivelin 56% apo 564 litra për konsumatorë në ditë (e përshtatur) në KRU 'Bifurkacioni', deri në 1,584 litra për konsumatorë në ditë (e përshtatur) në KRU 'Mitrovica', më 2015. Përkundër angazhimeve të brendshme të KRU dhe mbështetjes intensive të sektorit të ujit në Kosovë nga agjencitë donatore, që nga pas lufta, ato nuk ishin në gjendje që të

zgjidhnin situatën alarmuese të humbjes së ujit. Përkundrazi, UPF ka stagnuar në nivel të lartë në të gjitha KRU. Megjithëse një nivel i rrjedhjes (humbjeve fizike), është e natyrshme në operimin e rrjetit shpërndarës të ujit nën presion. Sfidë për kompanitë është për të lëvizur drejt një niveli ekonomik të rrjedhjes e cila balancon koston e prodhimit me koston e angazhimit për të kontrolluar nivelin e rrjedhjes.

Disa prej faktorëve të rëndësishëm, të cilat kanë impakt në nivelin e lartë të UPF janë:

- KRU nuk kanë në zbatim aktivitete të mirëfillta për reduktimin UPF, përfshirë edhe aktivitetet “pa shpenzime” siç janë inspektimet e rregullta, mbajtjen e shënimeve për riparimin e rrjedhjeve apo mirëmbajtjes së skicave për shpeshësinë e rrjedhjeve,
- mungesa e fondeve në dispozicion të kompanisë, sidomos mundësitë e kufizuara për të pasur investime kapitale për zëvendësimin e gypave dhe lidhjeve në shërbim,
- humbja e dinamikës së përpjekjeve për reduktimin e UPF, sapo agjencitë donatore kanë përfunduar projektet e tyre,
- zhvillimi, shpesh i paplanifikuar dhe i paautorizuar, që po ndodh më shpejt sesa që mund ta përcjellin shërbimet komunale,
- mungesa e programit/ strategjisë së detajuar si duhet për reduktimin e UPF në asnjërin nga KRU në Kosovë, e cila do të mbulonte të gjitha aspektet e ndryshme të problemit.

Për ti bërë të efektshëm aktivitetet e KRU për reduktimin e UPF, së pari duhet kuptuar sa e ndërlikuar është çështja e UPF dhe komponentëve të saj përfshirë edhe humbjet komerciale. Ata duhet të sigurohen që për këtë detyrë specifike të vënë në dispozicion të gjitha resurset në nivel të kompanisë. Si do që të jetë nëse KRU dëshirojnë të kenë një reduktim të ndjeshëm të UPF, ato duhet të ndërmarrin masat në vijim:

Aktivitete përgatitore për reduktimin e humbjeve të ujit, hartimi i programeve për reduktimin UPF të cilat përfshijnë një numër veprimesh dhe kërkojnë të dhëna/ materiale të shumta.

- reduktimi i humbjeve fizike, përmes menaxhimit të rrjedhjeve dhe presionit, kontrolli i rrjedhjeve aktive, shpejtësia dhe cilësia e riparimeve dhe menaxhimi i aseteve,
- kontrolli i rrjedhjeve aktive, përmes Zonave të Matjes (DMA) dhe matjet e rrjedhjeve minimale të natës si pjesë e programit të kontrollit të rrjedhjeve aktive e cila është bërë procedurë- model për industrinë e ujit dhe është e pranuar ndërkombëtarisht,
- reduktimin e kohëzgjatjes së rrjedhjeve, nga plasaritjet e gypave të cilat shkaktojnë humbje të ujit të mëdha, sidomos rrjedhjet e vogla nëntokë është vështirë për t'i gjurmuar dhe nëse nuk zbulohen për disa javë ato shkaktojnë humbje të vëllimeve të mëdha të ujit, e që mund të jenë shumë më shumë se ato të plasjeve të mëdha të gypave,
- kontrolli dhe menaxhimi i shtypjes është një metodë tjetër e rëndësishme e reduktimit të humbjeve fizike. Aftësia për të kontrolluar shtypjen i shërben dy objektivave kryesore: së pari, ajo minimizon potencialin e rrjedhjeve të reja dhe së dyti, ajo redukton sasinë e ujit që humbet, pasi të ketë ndodhur rrjedhja.
- menaxhimi i aseteve, është imperativ për një menaxhim ekonomik të rrjedhjeve. Kjo kërkon caktimin e prioriteteve dhe vendimeve se a duhet riparuar, zëvendësuar apo rehabilituar asetet,
- humbjet komerciale, paraqesin ujin e prodhuar që konsumohet por që nuk paguhet nga konsumatori dhe vëllimi i tij mund të jetë më i madh se sa ai i humbjeve fizike. Humbjet fizike në përgjithësi paraqesin një vlerë më të ulët monetare sepse reduktimi i humbjeve fizike e ulë koston e prodhimit, ndërsa reduktimi i humbjeve komerciale rrit të hyrat e kompanisë së ujit. Aktivitetet për reduktimin e humbjeve komerciale zakonisht janë me kosto më të ulët krahasuar me programet për reduktimin humbjeve fizike dhe mund të shpaguejnë investimet për aktivitete rreth UPF brenda një periudhe të shkurtër
- mirëmbajtja e ujëmatësve, që nuk funksionojnë si duhet, e regjistrojnë konsumin e konsumatorit në mënyrë jo të saktë. Është e ditur që ujëmatësit në fakt dëmtohen me kalimin e kohës.,

Nëse KRU-të do të mund të ndërmerrin masat e sipër përmendura do të mund të bëjnë më shumë për reduktimin e UPF-së, dhe si rezultat, rritjen e të hyrave nga shitja e ujit, si dhe plotësimin e kërkesës në zonat ku ka reduktime të furnizimit me ujë. Duhet theksuar se reduktimi i UPF kërkon një përkushtim afatgjatë nga i gjithë personeli i kompanisë.

SHTOJCA 1 Të dhënat e detajuara të performancës

Koncepti i monitorimit të performancës i udhëhequr nga ARRU është në përputhje me kërkesat specifike rregullatore. Të dhënat operative dhe të dhënat e shërbimeve ndaj konsumatorëve janë përshtatur me kërkesat për të monitoruar dhe raportuar nivelin e përmbushjes së standardeve të shërbimit, po ashtu edhe të dhënat financiare, janë të harmonizuara me udhëzimet rregullatore të kontabilitetit dhe me modelet e planifikimit të biznesit, për të vlerësuar nivelin e përmbushjes së objektivave të dakorduara me proceset tarifore.

Të dhënat e ofruara nga ofruesit e shërbimeve të ujit janë verifikuar/audituar¹⁵ nga ARRU, përmes një procesi transparent dhe të verifikueshëm. Përderisa përgjegjësia për raportimin e të dhënave të sakta dhe të besueshme qëndron tek kompanitë, ARRU është përgjegjës për vlerësimin e këtyre të dhënave në kontekst të saktësisë dhe besueshmërisë së burimit të tyre.

Rregullatori në vazhdimësi kërkon nga KRU, informacion të besueshëm, të saktë dhe në kohë në mënyrë që të veprojë në mënyrë efektive për të përmbushur funksionet dhe përgjegjësitë e saja institucionale. Të dhënat përfshijnë aspektet nga fusha e shërbimeve ndaj konsumatorëve: ankesat, konsumatorët, të dhënat operative: pronat, asetet, apo të dhënat financiare: të hyrat, shpenzimet, etj.

Të dhënat financiare siç janë: shpenzimet operative, të ardhurat nga shitjet, shpenzimet kapitale në përgjithësi mbahen në module softuerike (pronat, piano, navision, rikont, alpha), disa prej tyre nuk kanë mundësinë e ndarjes sipas kosto qendrave apo ndarjet në zëra të shpenzimeve, të cilat pastaj në mënyrë manuale barten në Excel formate. Përderisa të dhënat për zhvlerësimin sipas kosto aktuale, të dhënat për bazën rregullatore të asetëve për ujë dhe ujëra të zeza mbahen në format të excel-it, në përgjithësi të dhënat financiare kanë rezultuar të jenë kryesisht të besueshme.

Rregullatori ka shqetësime në lidhje me besueshmërinë e disa të dhënave operative (prodhimi i ujit, pronat me shtypje jo adekuate, pronat me furnizim të kufizuar) apo edhe disa të dhëna të shërbimeve ndaj konsumatorëve, të cilat jo gjithë herë janë të besueshme si për shkakun e mos përditësimit të rregullt, ashtu edhe për shkakun e sigurisë që ofron sistemi i mbajtjes së të dhënave në formate softuerike (Excel, apo word dokument). Po ashtu në besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave ka ndikuar edhe ndërrimi i shpesh të stafit i cili është angazhuar në procesin e raportimit, tek disa KRU.

Gjatë përpilimit të raportit të performancës për 2015, ARRU ka marrë parasysh vetëm të dhënat e gjetura gjatë procesit të auditimit.

Ne gjithashtu rekomandojmë ndryshimet kulturore tek menaxhmenti brenda KRU, për të krijuar vetëdijen se ata, përfshirë edhe çdo zyrtarë tjetër i involvuar në procesin e raportimit, janë përgjegjës për sigurimin e informacionit të besueshëm, të saktë dhe në kohë.

Statistikat e detajuara të performancës së shtatë KRU janë të paraqitura në tabelat në vijim. Informatat e prezantuara pra, janë të bazuara në dorëzimin e rregullt të raporteve në ARRU.

- të dhënat në lidhje me statistikën e popullsisë, numrin e konsumatorëve, gjatësisë së gypave, etj. nuk janë të dhëna të fund vitit por mesatare të vlerësuara të vitit.
- të dhënat financiare të shprehura në EUR, janë të përshtatura në nivelet e çmimeve të mesit të vitit 2015 e në përputhje me statistikën e publikuar të inflacionit për të mundësuar krahasimet e duhura nga viti në vit.
- të dhënat financiare janë raportuar në përputhje me, Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR), e në veçanti:
 - ✓ përcaktimi i vlerës së asetëve është bërë në bazë të Bazës Rregullatore të Asetëve,
 - ✓ mirëmbajtja kapitale është definuar si kombinim i ripërtëritjeve infrastrukturore dhe zhvlerësimit sipas kosto aktuale të asetëve jo-infrastrukturore,
 - ✓ provizionimi i borxheve të këqija (shlyerja) është definuar si dallimi në mes faturimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga viti i kaluar,
- performanca e arkëtimit të të ardhurave është definuar si dallimi në mes të faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza (duke përfshirë taksat e kyçjeve dhe të ardhurat tjera) dhe të ardhurat në kesh për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza (poashtu duke përfshirë taksat e kyçjes dhe të ardhurat tjera)

¹⁵ Raportet e auditimit/inspektimit e të dhënave të raportuara, janar-dhjetor, 2015

KRU Prishtina (Prishtinë)

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2014	2015
W - Furnizimi me ujë						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia	Cilësia e ujit (bakteriologjike)	W.1.A.01	% e tes. të kaluara	99.5%	100%
		Cilësia e ujit (fizike dhe kimike)	W.1.A.02	% e tes. të kaluara	99.2%	100%
	Shtypja	Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.03	Nr	145	130
		Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.04	% e pronave	0.16%	0.13%
	Besueshmëria	Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.05	Nr	16,418	10,441
		Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.06	% e pronave	18%	11%
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.07	Nr	23,914	52,613
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.08	% e pronave	26%	54%
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.09	Nr	51,893	35,002
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.10	% e pronave	56%	36%
Shërbyeshmëria infrastrukturore	Uji i pa-faturuar	Uji i pa-faturuar (totali)	W.1.B.01	m3 në vit	18,452,520	20,899,398
		Uji i pa-faturuar (për kycje)	W.1.B.02	litra për kons. për ditë	486	517
		Uji i pa-faturuar (për kycje) – i rregulluar	W.1.B.03	litra për kons. për ditë	588	613
		Uji i pa-faturuar (si përqindje e prodhimit)	W.1.B.04	% e prodhimit	49%	51%
	Plasartjet e gypave	Frekuenca e plasartjeve në rrjetin e gypave	W.1.B.05	plasartjet për muaj	154	118
		Plasartjet e gypave të rrjetit për 100 km të gypit	W.1.B.06	Nr / 100 km	148	83
Jo-financiar (komercial)						
Shtirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	W.2.A.01	Nr	92,225	98,056
		Shtirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	W.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	101%	106%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	W.2.A.03	Nr	6,045	5,617
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	W.2.A.04	Nr	837	777
Matja e ujit	Norma me ujëmatës	Konsumatorët shtëpiak me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak	W.2.B.01	% totali i kons. shtëpiak	98%	97%
		Konsumatorët kom & inst me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve kom & inst	W.2.B.02	% kom & inst	99%	100%
	Ujëmatësit e instaluar	Ujëmatësit e instaluar (shtëpiak)	W.2.B.03	Nr	288	457
		Ujëmatësit e instaluar (kom & inst)	W.2.B.04	Nr	67	70
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranuar (teknike)	W.2.C.01	Nr	5,591	6,146
		Ankesat e pranuar (komerciale)	W.2.C.02	Nr	5,180	2,132
Financiar						
Shitjet	Volumet	Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës)	W.3.A.01	m3	14,714,305	15,560,617
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	86%	81%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës)	W.3.A.03	m3	500,630	750,951
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	91%	273%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës)	W.3.A.05	% e vlerësimit sipas planit	3,870,125	4,048,894
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.06	% e vlerësimit sipas planit	82%	84%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës)	W.3.A.07	% e vlerësimit sipas planit	17,307	22,570
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.08	% e vlerësimit sipas planit	245%	0%
	Vlerat	Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak	W.3.A.09	EUR	6,866,726	7,547,790
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.10	% e vlerësimit sipas planit	88%	87%
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst	W.3.A.11	EUR	3,786,281	4,040,122
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.12	% e vlerësimit sipas planit	84%	87%
Kostoja për njësi	Prodhimi	Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.01	EUR/m3	0.063	0.056
		Kostoja totale për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.02	EUR/m3	0.067	0.060
	Kostoja totale	Kostoja për njësi të ujit të shitur	W.3.B.03	EUR/m3	0.495	0.450
		Kostoja për njësi të ujit të shitur dhe të paguar	W.3.B.04	EUR/m3	N/A	
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtja kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	W.3.C.01	EUR	519,660	231,031
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	W.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	8%	4%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	W.3.C.03	% e BRA	2.4%	1.1%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	W.3.C.04	EUR	933,493	708,777
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	W.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	7.8%	6.0%

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2014	2015
K- Ujërat e zeza						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	S.1.A.01	% e tes. të kaluara	N/A	N/A
Besueshmëria	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	S.1.B.01	Nr	3,705	2,716
		Vërshimet e rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.B.02	Nr për 100 km	1,090	799
Shërbyeshmëria	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	S.1.C.01	Nr	0	0
		Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.C.02	Nr për 100 km	0	0
	Mbingarkimet e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza	S.1.C.03	Nr	N/A	N/A	
Jo-financiar (komercial)						
Shtirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	S.2.A.01	Nr	75,992	82,670
		Shtirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	S.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	83%	89%
		Konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza	S.2.A.03	Nr	0	0
		Shtirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza në raport me totalin)	S.2.A.04	% totali i kons. shtëpiak	0%	0%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	S.2.A.05	Nr	6,479	6,877
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	S.2.A.06	Nr	985	861
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranua (teknike)	S.2.B.01	Nr	58	0
		Ankesat e pranua (komerciale)	S.2.B.02	Nr	0	0
Financiar						
Shitjet	Vlerat	Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak	S.3.A.01	EUR	629,710	698,521
		Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	88%	88%
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst	S.3.A.03	EUR	417,861	439,251
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	84%	86%
Kostoja për njësi	Trajtimi dhe shkarkimi	Kosto operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për m ³	S.3.B.01	EUR/m ³	N/A	N/A
		Totali i koston të trajtimit dhe shkarkimit për m ³	S.3.B.02	EUR/m ³	N/A	N/A
		Kostoja operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.03	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.04	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
	Grumbullimi	Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.05	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.06	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.07	EUR/ kons. shtëpiak	2.95	1.5
		Totali i koston për shërbime të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.08	EUR/ kons. shtëpiak	3.13	1.64
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtje kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	S.3.C.01	EUR	10,303	6,196
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	S.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	156%	3%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	S.3.C.03	% e BRA	0.1%	0.1%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	S.3.C.04	EUR	129,248	15,123
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	S.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	257%	27%
F – Financiar						
Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave						
Shitjet	Totali i shitjeve		F.1.A.01	EUR	11,700,579	12,725,684
	Totali i shitjeve në raport me planin		F.1.A.02	% e vlerësimit sipas planit	87%	87%
Eficienca e arkëtimit	Totali i të ardhurave të arkëtuara		F.1.B.01	EUR	9,323,407	9,609,573
	Totali i tejkalimit të arkëtimit të të ardhurave		F.1.B.02	EUR	-359,632	-1,786,832
	Totali i tejkalimit të arkëtimit të të ardhurave (relative)		F.1.B.03	% e vlerësimit sipas planit	96%	84%
	Totali i të ardhurave të shlyera		F.1.B.04	EUR	2,972,244	2,377,172
	Totali i të ardhurave të shlyera në raport me totalin e faturimit		F.1.B.05	% e faturimit	25%	19%
	Arkëtimi i të ardhurave në raport me faturimin		F.1.B.06	% e faturimit	80%	76%
	Llogaritë e arkëtueshme		F.1.B.07	EUR	N/A	N/A
	Llogaritë e arkëtueshme në raport me qarkullimin		F.1.B.08	Qarkullimi në ditë	N/A	N/A
Vlerat kyçe financiare dhe normat						
Vlerat		Rjedha e lirë e parasë së gatshme	F.2.A.01	EUR	N/A	N/A
Normat	Kthimet	Kthimi në kapital	F.2.B.01	%	-2.05%	4.82%
		Kosto e borxhit	F.2.B.02	%	N/A	N/A
		Leva financiare	F.2.B.03	normë	N/A	N/A
	Normat	Mbulesa e interes të parasë së gatshme	F.2.B.04	normë	N/A	N/A
		Fondet nga operacionet/borxhi	F.2.B.05	normë	N/A	N/A
		Norma e mbulimit të shërbimit të borxhit	F.2.B.06	normë	N/A	N/A

KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren)

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2014	2015
W - Furnizimi me ujë						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia	Cilësia e ujit (bakteriologjike)	W.1.A.01	% e tes. të kaluara	88.0%	92.9%
		Cilësia e ujit (fizike dhe kimike)	W.1.A.02	% e tes. të kaluara	99.6%	99.7%
	Shtypja	Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.03	Nr	0	0
		Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.04	% e pronave	0%	0%
	Besueshmëria	Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.05	Nr	34,148	35,965
		Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.06	% e pronave	99%	99%
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.07	Nr	200	200
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.08	% e pronave	1%	1%
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.09	Nr	300	200
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.10	% e pronave	1%	1%
Shërbyeshmëria infrastrukturore	Uji i pa-faturuar	Uji i pa-faturuar (totali)	W.1.B.01	m3 në vit	9,063,577	10,010,227
		Uji i pa-faturuar (për kycje)	W.1.B.02	litra për kons. për ditë	705	654
		Uji i pa-faturuar (për kycje) – i rregulluar	W.1.B.03	litra për kons. për ditë	707	655
		Uji i pa-faturuar (si përqindje e prodhimit)	W.1.B.04	% e prodhimit	59%	58%
	Plasaritjet e gypave	Frekuenca e plasaritjeve në rrjetin e gypave	W.1.B.05	plasaritjet për muaj	226	156
		Plasaritjet e gypave të rrjetit për 100 km të gypit	W.1.B.06	Nr / 100 km	532	366
Jo-financiar (komercial)						
Shtërjja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	W.2.A.01	Nr	34,648	36,366
		Shtërjja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	W.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	65%	67%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	W.2.A.03	Nr	2,021	1,415
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	W.2.A.04	Nr	258	189
Matja e ujit	Norma me ujëmatës	Konsumatorët shtëpiak më ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak	W.2.B.01	% totali i kons. shtëpiak	97%	95%
		Konsumatorët kom & inst me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve kom & inst	W.2.B.02	% kom & inst	99%	98
	Ujëmatësit e instaluar	Ujëmatësit e instaluar (shtëpiak)	W.2.B.03	Nr	1,425	0
		Ujëmatësit e instaluar (kom & inst)	W.2.B.04	Nr	255	0
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranuar (teknike)	W.2.C.01	Nr	719	878
		Ankesat e pranuar (komerciale)	W.2.C.02	Nr	742	510
Financiare						
Shitjet	Volumet	Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës)	W.3.A.01	m3	5,569,102	5,335,395
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	86%	76%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës)	W.3.A.03	m3	373,394	773,761
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	112%	243%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës)	W.3.A.05	% e vlerësimit sipas planit	1,209,840	1,084,407
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.06	% e vlerësimit sipas planit	82%	70%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës)	W.3.A.07	% e vlerësimit sipas planit	28,473	104,899
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.08	% e vlerësimit sipas planit	336%	1,727%
	Vlerat	Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak	W.3.A.09	EUR	2,528,886	2,631,707
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.10	% e vlerësimit sipas planit	89%	85%
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst	W.3.A.11	EUR	1,049,149	1,020,192
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.12	% e vlerësimit sipas planit	95%	81%
Kostoja për njësi	Prodhimi	Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.01	EUR/m3	0.083	0.082
		Kostoja totale për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.02	EUR/m3	0.085	0.085
	Kostoja totale	Kostoja për njësi të ujit të shitur	W.3.B.03	EUR/m3	0.413	0.396
		Kostoja për njësi të ujit të shitur dhe të paguar	W.3.B.04	EUR/m3	N/A	N/A
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtja kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	W.3.C.01	EUR	116,345	95,636
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	W.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	84%	26%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	W.3.C.03	% e BRA	1.7%	1.4%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	W.3.C.04	EUR	702,350	198,937
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	W.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	17.2%	3.5%

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2014	2015
K- Ujërat e zeza						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	S.1.A.01	% e tes. të kaluara	N/A	N/A
Besueshmëria	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	S.1.B.01	Nr	811	987
		Vërshimet e rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.B.02	Nr për 100 km	300	366
Shërbyeshmëria	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	S.1.C.01	Nr	88	45
		Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.C.02	Nr për 100 km	32.6	16.7
	Mbingarkimet e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza	S.1.C.03	Nr	N/A	N/A	
Jo-financiar (komercial)						
Shtrirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	S.2.A.01	Nr	29,811	31,292
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	S.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	56%	58%
		Konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza	S.2.A.03	Nr	0	0
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza në raport me totalin)	S.2.A.04	% totali i kons. shtëpiak	0%	0%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	S.2.A.05	Nr	1,837	1,126
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	S.2.A.06	Nr	269	174
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranua (teknike)	S.2.B.01	Nr	45	0
		Ankesat e pranua (komerciale)	S.2.B.02	Nr	20	0
Financiar						
Shitjet	Vlerat	Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak	S.3.A.01	EUR	251,306	312,973
		Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	89%	91%
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst	S.3.A.03	EUR	107,579	126,748
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	83%	76%
Kostoja për njësi	Trajtimi dhe shkarkimi	Kosto operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për m ³	S.3.B.01	EUR/m ³	N/A	N/A
		Totali i koston të trajtimit dhe shkarkimit për m ³	S.3.B.02	EUR/m ³	N/A	N/A
		Kostoja operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.03	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.04	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
	Grumbullimi	Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.05	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.06	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.07	EUR/ kons. shtëpiak	4.53	10.62
		Totali i koston për shërbime të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.08	EUR/ kons. shtëpiak	4.58	10.67
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtje kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	S.3.C.01	EUR	0	0
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	S.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	0%	0%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	S.3.C.03	% e BRA	0%	0%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	S.3.C.04	EUR	176,040	856,593
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	S.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	88.5%	15.8%
F – Financiar						
Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave						
Shitjet	Totali i shitjeve		F.1.A.01	EUR	3,936,920	4,091,619
	Totali i shitjeve në raport me planin		F.1.A.02	% e vlerësimit sipas planit	90%	84%
Eficienca e arkëtimit	Totali i të ardhurave të arkëtuara		F.1.B.01	EUR	2,971,440	3,036,614
	Totali i tejkallimit të arkëtimit të të ardhurave		F.1.B.02	EUR	-326,042	-758,837
	Totali i tejkallimit të arkëtimit të të ardhurave (relative)		F.1.B.03	% e vlerësimit sipas planit	90%	80%
	Totali i të ardhurave të shlyera		F.1.B.04	EUR	1,156,590	965,480
	Totali i të ardhurave të shlyera në raport me totalin e faturimit		F.1.B.05	% e faturimit	29%	24%
	Arkëtimi i të ardhurave në raport me faturimin		F.1.B.06	% e faturimit	75%	74%
	Llogaritë e arkëtueshme		F.1.B.07	EUR	N/A	N/A
	Llogaritë e arkëtueshme në raport me qarkullimin		F.1.B.08	Qarkullimi në ditë	N/A	N/A
Vlerat kyçe financiare dhe normat						
Vlerat		Rjedha e lirë e parasë së gatshme	F.2.A.01	EUR	N/A	N/A
Normat	Kthimet	Kthimi në kapital	F.2.B.01	%	-2.68%	-0.84%
		Kosto e borxhit	F.2.B.02	%	N/A	N/A
		Leva financiare	F.2.B.03	normë	N/A	N/A
	Normat	Mbulesa e interes të parasë së gatshme	F.2.B.04	normë	N/A	N/A
		Fondet nga operacionet/borxhi	F.2.B.05	normë	N/A	N/A
		Norma e mbulimit të shërbimit të borxhit	F.2.B.06	normë	N/A	N/A

KRU Hidrodrini (Pejë)

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2014	2015
W- Furnizimi me ujë						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia	Cilësia e ujit (bakteriologjike)	W.1.A.01	% e tes. të kaluara	97.7%	92%
		Cilësia e ujit (fizike dhe kimike)	W.1.A.02	% e tes. të kaluara	96.3%	93%
	Shtypja	Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.03	Nr	0	0
		Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.04	% e pronave	0%	0%
	Besueshmëria	Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.05	Nr	34,467	36,908
		Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.06	% e pronave	99%	100%
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.07	Nr	205	14
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.08	% e pronave	1%	0%
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.09	Nr	0	0
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.10	% e pronave	0%	0%
Shërbyeshmëria infrastrukture	Uji i pa-faturuar	Uji i pa-faturuar (totali)	W.1.B.01	m3 për ditë	21,095,517	16,776,858
		Uji i pa-faturuar (për kycje)	W.1.B.02	litra për kons. për ditë	1,475	1,101
		Uji i pa-faturuar (për kycje) – i rregulluar	W.1.B.03	litra për kons. për ditë	1,476	1,101
		Uji i pa-faturuar (si përqindje e prodhimit)	W.1.B.04	% e prodhimit	71%	66%
	Plasaritjet e gypave	Frekuenca e plasaritjeve në rrjetin e gypave	W.1.B.05	plasaritjet për muaj	128	57
		Plasaritjet e gypave të rrjetit për 100 km të gypit	W.1.B.06	Nr / 100 km	256	116
Jo-financiar (komercial)						
Shtrirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	W.2.A.01	Nr	34,672	36,921
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	W.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	91%	95%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	W.2.A.03	Nr	1,854	2,644
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	W.2.A.04	Nr	315	280
Matja e ujit	Norma me ujëmatës	Konsumatorët shtëpiak me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak	W.2.B.01	% totali i kons. shtëpiak	93%	95%
		Konsumatorët kom & inst me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve kom & inst	W.2.B.02	% kom & inst	97%	96%
	Ujëmatësit e instaluar	Ujëmatësit e instaluar (shtëpiak)	W.2.B.03	Nr	549	1,057
		Ujëmatësit e instaluar (kom & inst)	W.2.B.04	Nr	0	49
